

EPOKA ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5538
E shtunë, 28 korrik 2018
çmimi 0.40 €

Merren masa shtesë për parandalimin e aksidenteve

Të premtën është mbajtur takimi i Këshillit për Siguri në Trafikun Rrugor, me qëllim të marrjes së masave adekuatë për uljen e aksidenteve në trafikun rrugor, e sidomos të atyre me pasojë vdekjen | **FAQE 8**



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", ALI BERISHA | **FAQE 4-5**

Qeveria nuk është e rrezikuar nga mocioni i opozitës

Nënkryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ali Berisha, ka thënë se Qeveria Haradinaj nuk ndihet e rrezikuar nga mocioni i opozitës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se opozita me deklaratimet për rrëzimin e Qeverisë ka vetëm një qëllim: ta mbajë të zgjuar elektoratin. Berisha, i cili mban edhe postin e zëvendësministrit në këtë Qeveri, ka vlerësuar se koa-

licioni qeverisës është duke kryer punë të mëdha. Sipas tij, problemet që kanë qëndruar për vite të tëra në sirtarët e qeverive të kaluara kanë filluar të zgjidhen nga kjo Qeveri. Berisha i ka bërë thirrje opozitës t'i votojë projektligjet që janë në dobi të Kosovës dhe të qytetarëve të saj, e të mos e shikojë vetëm interesin partiak e politik



AKTUALE

VDEKJA E TË PAVDEKSHMIT

F. 8

Agim VINCA



FILOZOFIA DHE ETIKA POLITIKE E ADEM DEMAÇIT

F. 12

Dr. Sabri KIÇMARI



RECIPROCITET APO ASOCIACION TË KOMUNAVE?

F. 12

Valon MURATI



SOT (E SHTUNË), NË ORËN 12:00, ME CEREMONI SHTETËRORE DO T'I JEPET LAMTUMIRA E FUNDIT VEPRIMTARIT TË ÇËSHTJES KOMBËTARE, ADEM DEMAÇIT

LAMTUMIRË, BACË!



Me intonimin e himnit të Kosovës, të himnit kombëtar dhe me një minutë heshtje, Kuvendi i Kosovës ka mbajtur të premtën seancë përkujtimore kushtuar jetës dhe veprës së Adem Demaçit, i cili vdiq të enjten në Prishtinë, në moshën 82-vjeçare. Në këtë seancë nga përfaqësues të institucioneve të Kosovës, të Shqipërisë dhe të Maqedonisë, u tha se Demaçi ishte ndër figurat më të mëdha të këtyre 100 vjetëve të fundit. Pas seancës përkujtimore, në hollin e Kuvendit të Kosovës kanë vazhduar homazhet në nderim të veprës së Adem Demaçit. Trupi i simbolit të rezistencës kombëtare do të prehet i qetë në Varrezat e Dëshmorëve në Prishtinë | **FAQE 6-7**

Kërkohet plan për zgjidhjen e rasteve të grumbulluara në prokurori dhe gjykata | **FAQE 3**

EKONOMI

AEROPORTI I PRISHTINËS, TRAJNIME TË AUTORIZUARA NGA IATA DHE SWISS

F. 9

REÇICA VAZHDON PËR PJEKJET PËR KRIJIMIN E VENDEVE TË REJA TË PUNËS

F. 9

SPORT

HARADINAJ: BASKETBOLLISTËT DO TA KENË PËRKRAHJEN INSTITUCIONALE NË GARAT NDËRKOMBËTARE

F. 18

SHTYHET NDESHJA TESTUESE PËR SHKAK TË VDEKJES SË ADEM DEMAÇIT

F. 18

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Kurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Hahni: Kosova t'i zgjidhë mosmarrëveshjet me Serbinë para anëtarësimit në BE

BRUKSEL, 27 KORRIK - Bashkimi Evropian (BE) ka alarmuar për rolin e Kinës në Ballkanin Perëndimor, duke paralajmëruar se Pekini mund t'i kthejë vendet e rajonit në "kuaj të Trojës". Komisionari evropian për zgjerim, Johannes Hahn, ka thënë për "Politico.eu" se "kombinimi i kapitalizmit dhe një diktature politike kineze" mund t'u përsh-

tatet disa udhëheqësve në rajon. Ndonëse shqetësimet perëndimore rreth Ballkanit janë përqendruar në rolin e Rusisë, Hahni ka thënë se ka më shumë arsye për të qenë të shqetësuar lidhur me ndikimin e Kinës, e cila ka bërë një seri investimesh të rëndësishme në projektet e infrastrukturës. I pyetur rreth mundësisë së kri-

jimit të "kuajve të Trojës", duke përdorur fuqinë e saj financiare për ta shtrirë ndikimin politik mbi vendet që aspirojnë t'i bashkohen Bashkimit Evropian, Hahni ka përmendur shembullin e një autostrade në Mal të Zi që ndërtohet dhe financohet nga Kina. "Pikërisht ky është rasti me këtë autostradë të famshme në Malin e Zi. Dhe,

gjithashtu, ky është një lloj modeli, ose të themi modeli i biznesit, nga kinezët për të ofruar kredi tërheqëse duke u kthyer në kapital. Mendoj se duhet të jemi të vetëdijshëm për konceptin strategjik të Kinës dhe të reagojmë në mënyrë adekuate. Unë mendoj se kjo do të jetë një nga sfidat më të mëdha të Evropës", është shprehur Hahni.



Pacolli: Ambasadorja Haley, mbështetësja më e madhe e Kosovës

Zëvendëskryeministri i parë i Kosovës dhe ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, është takuar me e ambasadorën e ShBA-së në OKB, Nikki Haley, për të cilën ka thënë se është mbështetësja më e madhe e Kosovës, që përballet me të gjitha ata që sulmojnë të ardhmen e shtetit tonë

PRISHTINË, 27 KORRIK - Zëvendëskryeministri i parë i Kosovës dhe ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, në kuadër të vizitës në Amerikë, është takuar me ambasadorën e këtij shteti në OKB, Nikki Haley. Ai ka thënë se ambasadorja Haley është mbështetësja më e madhe e Kosovës. "Nikki Haley, ambasadorja e ShBA-së në OKB, është mbështetësja më e madhe e Kosovës, e cila përballet me të gjitha ata që sulmojnë të ardhmen e shtetit tonë. Diskutimet e saj për Kosovën në Këshillin e Sigurimit na bëjnë krenarë për miqësinë dhe lidhjet historike me ShBA-në", ka shkruar Pacolli në llogarinë e vet në "Facebook". Pacolli, i cili po qëndron në një vizitë zyrtare në Uashington, ka thënë se Kosova është me fat që në rrugëtimin e vet nuk është vetëm.

"Gjatë qëndrimit në Uashington, kënaqësi ta takoj sekretarin e Shtetit, Mike Pompeo. Kosova është me fat që në rrugëtimin e vet nuk është vetëm", ka shkruar ai në Facebook.

Ndërsa ministri i Jashtëm serb, Ivica Daciq, ka takuar të enjten në Uashington këshilltarin e Donald Trumpit për siguri kombëtare, John Bolton, i cili njihet për qëndrimet e tij proserbe.

Pacolli: Kosova i respekton të drejtat fetare të të gjitha komuniteteve

Ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, ka marrë pjesë në konferencën për liritë fetare në Uashington, ku ishte i ftuar nga sekretari i Shtetit, Mike Pompeo. Ai ka thënë se Kosova është një

vend në të cilin respektohen plotësisht liritë fetare të të gjitha komuniteteve, duke shtuar se të gjithë jetojnë në harmoni dhe bashkëjetesë. "Harmonia ndër-fetare është parim për të cilin jemi kujdesur me shikuj dhe nuk kemi lejuar që ideologjitë dhe sistemet politike ta thyjnë atë", ka shkruar Pacolli në profilin e vet në "Facebook".

Pacolli ka shtuar se Kosova është e përkushtuar shumë në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe se është duke u punuar për një ligj modern për liritë dhe të drejtat fetare. "Një nga përkushtimet tona ka qenë të ndërtojmë Kosovën si shtet laik dhe për të ndarë në mënyrë të qartë dhe të vendosur çështjet shtetërore nga ato fetare", ka shkruar Pacolli.

Ai ka falënderuar Shtetet e Bashkuara për ndihmën që i kanë



dhënë vendit tonë.

Në vazhdim të fjalimit të tij, ai ka folur edhe për Kushtetutën moderne të Kosovës sa i përket ndarjes së çështjeve shtetërore nga ato fetare; promovimit të drejtave dhe lirive të njeriut, atyre politike, sociale dhe kulturore në përputhje me instrumentet e Kombeve të Bashkuara dhe të

Këshillit të Evropës; procesin e miratimit të Ligjit modern për liritë dhe të drejtat fetare; idenë për themelimin e një zyre për komunitetet fetare brenda zyrës së kryeministrit dhe iniciativën ndër-fetare në Kosovë, me qëllim të krijimit të mundësive për komunitetet që ato të ndërveprojnë në mes vete.

Lisa Magno bëri betimin si drejtoreshë e misionit të USAID-it në Kosovë



PRISHTINË, 27 KORRIK - Lisa Magno ka bërë të premtën betimin si drejtoreshë e misionit të USAID-it në Kosovë në një ceremoni të udhëhequr nga ambasadori i ShBA-së në Kosovë, Greg Delawie. Në këtë ceremoni, e cila për herë të parë mbahet në Prishtinë, morën pjesë ndihmësadministratori i USAID-it për

Evropë dhe Euroazi, Brock Bierman, kryeministri Ramush Haradinaj si dhe zyrtarë të tjerë të Kosovës dhe të Ambasadës së ShBA-së në Prishtinë. Në fjalën e tij, ambasadori Delawie ka shprehur lëvdata për shkathësitë profesionale të znj. Magno të treguara gjatë mandatit të saj në Kosovë si zëvendësdrejtoreshë e

misionit të USAID-it si dhe për punën e saj të mëhershme me USAID-in në Filipine, Guatemalë, Afganistan dhe më rishtazi në Uashington ku ajo shërbeu në cilësinë e zyrtares mbikëqyrëse të programeve dhe ushtrueses së detyrës së zëvendësadministratorës për Zyrën e Evropës dhe Euroazisë.

Ngritja e cilësisë në arsim, indikator kryesor për transformimin e një shteti

PRISHTINË, 27 KORRIK (ER) - Ministri i Arsimit, Shyqiri Bytyqi, ka pritur të premtën në takim presidenten e RIT Kosova (AUK), Sharon Y. Hart, me të cilën ka biseduar për rritjen e bashkëpunimit në funksion të përmirësimit të gjendjes

në arsimin e lartë në Kosovë. "Vazhdimisht e kam vlerësuar punën dhe të arriturat e stafit akademik dhe të studentëve të RIT Kosova (AUK), të cilët kanë ndikuar ndjeshëm në rritjen e standardeve të arsimit të lartë në

Kosovë. Ndër të tjera, shpreha edhe gatishmërinë për të bashkëpunuar me këtë institucion të arsimit të lartë dhe kam mirëpritur vullnetin e tyre për të dhënë komente në projektligjin për arsimin e lartë në Kosovë", ka

thënë Bytyqi. Ai ka bërë me dije se bashkë me presidenten e RIT Kosova (AUK) janë pajtuar që ngritja e cilësisë në arsim është indikator kryesor nga ku fillon zhvillimi dhe transformimi i një shteti.



Mbahet takimi i nëntë i nivelit të lartë të sundimit të ligjit

Kërkohet plan për zgjidhjen e rasteve të grumbulluara në prokurori dhe gjykata



Kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se Kosova është konsistente dhe e pakompromis në fuqizimin e shtetit ligjor, si e vetmja rrugë që garanton zhvillimin e vendit. Këtë deklaratë Haradinaj e ka dhënë të premtën në takimin e nivelit të lartë të sundimit të ligjit, me aktorët e fushës relevante dhe partnerët ndërkombëtarë, ku shqyrtuan mundësitë e rritjes së efikasitetit në pastrimin e lëndëve gjyqësore, kryesisht korrupsion e krim i organizuar, dhe atyre të grumbulluara

**EPOKA
ERE** Qendresa RAMA

PRISHTINË, 27 KORRIK - "Përfaqësuesit e gjykatave dhe prokurorisë në vend duhet ta kenë një plan konkret menaxherial se si t'i qasen zgjidhjes së lëndëve të grumbulluara dhe të shënjestruara dhe i inkurajojmë institucionet tona që të angazhohen intensivisht në kryerjen e detyrave, veçmas për lëndët e grumbulluara dhe në një afat prej tre muajsh të kemi rezultate konkrete të përmirësimit të trendit sa i përket zgjidhjes së rasteve të grumbulluara", ky ishte

mesazhi i kryeministrit të Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, në takimin e nëntë me radhë të nivelit të lartë të sundimit të rendit dhe ligjit. Në këtë takim janë prezantuar të arriturat e muajve të fundit nga institucionet përkatëse, në veçanti u diskutua për rastet e shënjestruara që kanë të bëjnë me luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Kryeministri Haradinaj me këtë rast ka thënë se Qeveria e vendit është angazhuar në vazhdimësi të krijojë kushte më të mira pune për gjyqtarët e vendit, ta rrisë numrin e tyre, pagat dhe bux-

hetin operues dhe se tani është koha që kjo të konkretizohet edhe me rezultate pozitive sa i përket zgjidhjes së lëndëve që janë grumbulluar prej vitesh. "Zgjidhja e këtyre rasteve jo vetëm se shënon rezultat pozitiv në rrugën tonë drejt integritetit euroatlantik, por është e arritur e madhe edhe për fuqizimin e shtetit, për fuqizimin e familjes dhe të institucioneve. Nuk mund të mbesim peng i kohës. Duhet të instalojmë një dinamikë të re pune, disiplinë", ka deklaruar kryeministri Haradinaj. Po ashtu është prezantuar gjendja e lëndëve dhe rasteve nga

kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës, Enver Peci, kryetari i Gjykatës së Apelit, Hasan Shala, kryetari i Dhomës së Veçantë të Gjykatës Supreme, Sahit Sylejmani, kryetarja e Gjykatës Themelore të Prishtinës, Afërdita Bytyçi, kryetari i Gjykatës Themelore të Pejës, Kreshnik Radoniqi, kryetari i Gjykatës Themelore të Prizrenit, Ymer Hoxha, kryetari i Gjykatës Themelore të Gjilanit, Ramiz Azizi, kryetari i Gjykatës Themelore të Mitrovicës, Nikola Kabasić, kryetari i Gjykatës Themelore të Ferizajt, Bashkim Hyseni dhe kryetari i Gjykatës Themelore të Gjakovës, Valon Durguti. Përfaqësuesit e këtyre institucioneve shpallorën statistika dhe trendin e punës, numrin e gjykatësve aktivë, lëndët e proceduara dhe uljen e përqindjes së rasteve të grumbulluara, si dhe shprehën gatishmërinë dhe zotimet e tyre që rastet e shënjestruara të kenë prioritet

dhe të zgjidhen brenda afateve të parapara. Ambasadori i ShBA-së në Kosovë, Greg Delawie, dheshefja e misionit të BE-së, Nataliya Apostolova, vlerësuan angazhimin e institucioneve në zgjidhjen e rasteve, duke inkurajuar ato që kjo të vazhdojë dhe të shënojë progres, në mënyrë që të ketë rezultate konkrete.

Në përmbyllje të takimit, kryeministri Haradinaj ka bërë thirrje nga përfaqësuesit e institucioneve të rendit e ligjit që të instalojnë një dinamikë të re pune dhe plan menaxhimi konkret, që trendi i zgjidhjes së rasteve të ndryshojë dhe u zotua se do ta vazhdojë mbështetjen për këtë sektor.

Viti 2018 është shpallur viti i sundimit të rendit dhe ligjit në vend, derisa takimet e nivelit të lartë në këtë fushë po organizohen në përpjekje për ta ndryshuar situatën e krijuar prej dekadash në vend.

Lekaj i jep fund kontestit me "Infrakos"-in për segmentin në hyrje të Pejës



PRISHTINË, 27 KORRIK (ER) - Ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, me anë të një njoftimi në rrjetin social "Facebook", ka bërë me dije se ka nënshkruar marrëveshjen me Ndërmarrjen Publike "Infrakos", marrëveshje kjo që i jep fund kontestit gjyqësor në mes të Ministrisë së Infrastrukturës dhe "Infrakos"-it dhe lejon zhblokimin e punimeve në segmentin rrugor M9, në hyrje të qytetit të Pejës. "Sot u përmbyll

një çështje me rëndësi shumë të madhe për zhvillimin e infrastrukturrës rrugore të rajonit të Pejës. Pas disa vjetëve stërzgjatje dhe ballafaqime gjyqësore në mes të dy institucioneve publike, Ndërmarrjes Publike 'Infrakos' sh. a dhe Ministrisë së Infrastrukturrës, u arrit marrëveshja për zgjidhjen e kontestit gjyqësor dhe për zhblokimin e vazhdimin të punimeve në segmentin rrugor M9, në hyrje të

Pejës. Me këtë marrëveshje ne treguam se institucionet publike duhet të gjejnë gjuhë të përbashkët për mbrojtjen e interesave në kuadër të kompetencave të tyre ligjore, por edhe promovimin e interesit të përgjithshëm për zhvillimin e vendit. Tanimë nuk ka pengesa për vazhdimin e punimeve në segmentin rrugor M9 dhe zgjerimit të rrugës në hyrje të Pejës", ka shkruar Lekaj.

Flet për "Epokën e re", Ali Berisha

Qeveria nuk është e rreziku



Nënkryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ali Berisha, ka thënë se Qeveria Haradinaj nuk ndihet e rrezikuar nga mocioni i opozitës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se opozita me deklaratimet për rrëzimin e Qeverisë ka vetëm një qëllim, ta mbajë të zgjuar elektoratin. Berisha i cili mban edhe postin e zëvendësministrit në këtë Qeveri, ka vlerësuar se koalicioni qeverisës është duke kryer punë të mëdha. Sipas tij, problemet që kanë qëndruar për vite të tëra në sirtarët e qeverive të kaluara kanë filluar të zgjidhen nga kjo Qeveri. Berisha i ka bërë thirrje opozitës t'i votojë projektligjet që janë në dobi të Kosovës dhe qytetarëve të saj, dhe të mos e shikojë vetëm interesin partiak e politik

EPOKA E RE**Shqipe HETEMI**

PRISHTINË, 27 KORRIK - Nënkryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ali Berisha, ka thënë të premten se opozita me deklaratimet për rrëzimin e Qeverisë ka vetëm një qëllim, ta mbajë të zgjuar elektoratin e saj. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka bërë me dije se Qeveria Haradinaj nuk ndihet e rrezikuar nga mocioni i opozitës. "Prandaj jemi të sigurt se Qeveria do të vazhdojë punën e saj dhe nuk do të merret me deklaratat e opozitës nëse i ka apo jo votat për rrëzimin e

Qeverisë. Qeveria është duke punuar dhe efektet e kësaj punë, sidomos kohët e fundit, janë të dukshme. Qeveria nuk është e rrezikuar nga mocioni i opozitës. Deklarimet për rrëzimin e Qeverisë kanë për qëllim të mbajnë të zgjuar elektoratin e opozitës", është shprehur Berisha.

Ai ka vlerësuar se koalicioni qeverisës është duke kryer punën të mëdha dhe, sipas Berishës, problemet që kanë qëndruar për vite të tëra në sirtarët e qeverive të kaluara, kanë filluar të zgjidhen nga kjo Qeveri. "Kjo Qeveri ka arritur të kryejë shumë punë deri më tani. Detyrat që ka pasur Kosova për liberalizimin e vizave

tashmë janë kryer, ka ndryshime pozitive në sektorin e drejtësisë, shëndetësisë, infrastrukturës, arsimit, energjetikës dhe të tjerët me radhë. Janë miratuar një seri ligjesh të rëndësishme, në mesin e tyre edhe Ligji për Prishtinën. Prej një situatë kaotike situata ka filluar të stabilizohet me qeverisjen Haradinaj. Të gjitha ato që kanë qenë problematike për Kosovën, përfshirë edhe demarkacionin, janë duke u kryer. Pra, problemet që kanë qëndruar për vite të tëra në sirtarët e qeverive të kaluara kanë filluar të zgjidhen me këtë Qeveri", ka deklaruar ai. Berisha i ka bërë thirrje opozitës

t'i votojë projektligjet që janë në dobi të Kosovës dhe qytetarëve të saj dhe të mos shikojë vetëm interesin partiak e politik. Sipas Berishës, partitë politike duhet të arrijnë konsensus për dialogun në mënyrë që njëherë e përgjithmonë Kosova ta përmbyllë çështjen e pazgjidhur me Serbinë. "Nëse jemi të bashkuar në këtë proces, edhe arritja e marrëveshjes përfundimtare do të jetë më gjithëpërfshirëse, më e pranueshme dhe më e lehtë. Kosovës i duhet një konsensus i tillë në mënyrë që njëherë e përgjithmonë ta përmbyllë çështjen e pazgjidhur me Serbinë", ka thënë ai.

"Epoka e re": Z. Berisha, opozita ka paralajmëruar se ka arritur t'i sigurojë 58 vota për rrëzimin e Qeverisë, pra i duhen edhe tri vota për të iniciuar mocion të mosbesimit. I frikësoheni mocionit të mosbesimit dhe a ka rrezik që ndonjëri nga deputetët e komunitetit shumicë apo pakicë t'ju tradhetojë?

Berisha: Opozita në vazhdimësi që nga momenti i krijimit të Qeverisë ka deklaruar se kjo

Qeveri do të rrëzohet, mirëpo qeveritë nuk rrëzohen me deklaratat, por përmes proceseve demokratike që i njeh Kushtetuta e Kosovës dhe ligjet e saj, si është mekanizmi i votimit në Kuvend. Për asnjë moment deri më tani pozita e Qeverisë nuk ka qenë e rrezikuar sepse kemi kryer punë të mëdha të cilat nuk kanë mundur të kryhen për vite të tëra. Problemet e Kosovës që janë grumbulluar ndër vite janë duke u zgjidhur nga Qeveria aktuale. Prandaj deklaratimet për rrëzimin e Qeverisë kanë për qëllim që ta mbajnë të zgjuar elektoratin e opozitës.

"Epoka e re": Do të thotë se, të paktën, në këtë periudhë kohore Qeveria nuk ndihet e rrezikuar?

Berisha: Pozita nuk e sheh që është e rrezikuar në këtë periudhë kohore. Prandaj jemi të sigurt se Qeveria do ta vazhdojë punën e saj dhe nuk do të merret me deklaratat e opozitës nëse i ka apo jo votat për rrëzimin e Qeverisë. Qeveria është duke punuar dhe efektet e kësaj punë, sidomos kohët e fundit, janë të

ar nga mocioni i opozitës



Kuvendin e Kosovës, edhe në të kaluarën kur pozita nuk i ka pasur 80 vota partitë opozitare kanë votuar pro vetëm e vetëm që të mos humbin miliona euro në të mirë të Kosovës. Edhe tani besoj se do të ndodhë e njëjta gjë, meqë miratimi i këtyre projektligjeve është në dobi të qytetarëve.

"Epoka e re": Një çështje me të cilën po ballafaqohet Qeveria dhe Kosova në përgjithësi është edhe dialogu me Serbinë, do të mund Qeveria Haradinaj të krijojë konsensus për përfundimin e këtij procesi?

Berisha: Më e mira për Kosovë sa iu përket çështjeve të mëdha si dialogu dhe arritja e marrëveshjes përfundimtare me Serbinë, është arritja e konsensusit poli-

tik. Kosovës i nevojitet më shumë se kurrë një konsensus i madh politik për përmbylljen e një çështje shekullore me Serbinë. Kosova në asnjë moment dhe për asnjë çmim nuk guxon të tërhiqet dhe të ketë kompromise të reja. Kompromisi i vetëm i Kosovës është njohja e Serbisë, edhe pse Serbia ka vrarë dhe masakruar mijëra shqiptarë dhe i ka shkakuar shumë dëme ekonomike e sociale Kosovës. Kompromisi i vetëm si rezultat i një dialogu dhe një vullneti të Kosovës është njohja e Serbisë me gjithë dëmet që ia ka shkakuar Kosovës. Nuk do të ketë kompromise të tjera. Kosova ka territorin e vet ka Kushtetutën e saj prandaj, si e tillë, duhet të mbetet përgjithmonë. Çdo cenim i saj është shkelje e

Kushtetutës dhe është cenim i gjakut të derdhur të shqiptarëve për liri dhe pavarësi. Asnjë politikan dhe asnjë individë nuk guxon dhe nuk ka mandat të diskutojë për shkëmbim terrioresh me Serbinë.

"Epoka e re": Do të mund të arrihet apo jo konsensusi për dialog?

Berisha: Partitë politike duhet ta gjejnë formulën për arritjen e konsensusit për dialogun me Serbinë. Nëse jemi të bashkuar në këtë proces edhe arritja e marrëveshjes përfundimtare do të jetë më gjithëpërfshirëse, më e pranueshme dhe më e lehtë. Kosovës i duhet një konsensus i tillë në mënyrë që njëherë e përgjithmonë ta përmbyllë çështjen e pazgjidhur me Serbinë.

Ministrja Hoxha kërkon unitet për votimin e projektligjeve që janë pjesë e agjendës evropiane

PRISHTINË, 27 KORRIK (ER) - Ministrja e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, nëpërmjet një deklarate ka shprehur shqetësimin e thellë për mosmiratimin e tri projektligjeve në seancën e së enjtes të Kuvendit të Kosovës. Ajo ka ftuar grupet parlamentare për unitet dhe votim të këtyre projektligjeve në seancën e ardhshme, e cila do të mbahet të hënën. "Tri ligje, të rëndësishë së veçantë, pavarësisht prej miratimeve paraprake nga të gjitha partitë politike, nuk arrihen t'i bashkohen ato sërish për interesin madhor, brenda Kuvendit të Republikës së Kosovës. Për fat të keq, e enjtja ishte një ditë e rëndë, ditë e ndalimit të një procesi, i cili ishte, është dhe mbetet prioritet kombëtar. Interesat partiake u vunë mbi interesin e qytetarit", ka thënë ajo.

Hoxha ka shtuar se partitë politike dhe grupet parlamentare kanë mandat për ta përshpejtuar procesin integruar. Qytetarët e Republikës së Kosovës meritojnë të kenë qasje të plotë në fondet të cilat ndikojnë drejtpërdrejt që procesi i pandalshëm i integritimit me vlerat evropiane, të kryhet sa më parë.

Ministrja Hoxha ka thënë se miratimi i këtyre tri ligjeve në fillim të javës së ardhme mundëson aplikimin për projektet që nga 1 shtatori. "Në rastin më të keq, shtyrja e tri projektligjeve për miratim në shtator, pamundëson



aplikimin në fonde me vlerë mbi 80 milionë euro gjatë vitit 2018. Interesi i qytetarëve është i qartë, miratimi i ligjeve, publikimi në gazetën zyrtare dhe qasja në fonde, nga 1 shtatori. Ndryshe, procesi pëson dëme të rënda, të shkaktuara nga egot e partive politike. Këtë më së paku e meritojnë qytetarët e Republikës së Kosovës", ka thënë ministrja Hoxha, duke bërë me dije se Projektligji për marrëveshjen financiare IPA 2017, pjesa e parë, përfshin 11 projekte ku Kosova do të përfitonte 48 milionë euro, Programi "Evropa për qytetarët", përmban 187 milionë euro fonde që promovojnë qytetarinë aktive evropiane dhe si fokus ka autoritetet lokale, organizatat hulumtuese të politikave, grupet e qytetarëve dhe organizatat e shoqërisë civile si dhe "ERASMUS+", Programi për

Arsim, Trajnim, Rini dhe Sport, kapin vlerën gjithsejtë 300 milionë euro. "Përtej çdo ndarjeje, qytetarët e Kosovës presin nga pozita dhe opozita lehtësimin maksimal të procesit integruar, duke siguruar fonde për ekonominë tonë, për arsimin tonë, për projektet infrastrukturore tona, për shëndetësinë tonë, për fuqizimin e sundimit të ligjit dhe çdo fushë të jetës, që vendin tonë dhe qytetarët e Republikës së Kosovës, i bënë të barabartë me qytetarët e BE-së. Ftoj grupet parlamentare pa dallim partie, të kenë reflektim pozitiv ndaj pozicioneve të paraqitura në seancën e kaluar plenare. Nuk mund të imagjinojmë pse duhet të shkaktohet ky dëm ndaj qytetarëve dhe institucioneve të Republikës së Kosovës nga kushdo qoftë", ka thënë ministrja e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha.

dukshme. Qeveria nuk është e rezikuar nga mocioni i opozitës.

"Epoka e re": Ju po e lavdëroni punën e Qeverisë, kurse opozita që të shkohet në zgjedhje të reja meqë, sipas saj, qeverisja e koalicionit PAN po e kthen pas Kosovën. Kujt duhet t'i besojnë qytetarët? Dhe cili version është real?

Berisha: Qytetarët nuk duhet t'u besojnë as deklaratave të Qeverisë dhe as të opozitës, por duhet t'u besojnë veprave. Kjo Qeveri ka arritur të kryejë shumë punë deri më tani. Detyrat që ka pasur Kosova për liberalizimin e vizave tashmë janë kryer, ka ndryshime pozitive në sektorin e drejtësisë, shëndetësisë, infrastrukturës, arsimit, energjetikës dhe të tjerët me radhë. Janë miratuar një serë ligjesh të rëndësishme në mesin e tyre edhe Ligji për Prishtinën. Prej një situatë kaotike situata ka filluar të stabilizohet me qeverisjen Haradinaj. Të gjitha ato që kanë qënë problematike për Kosovën, përfshirë edhe demarkacionin, janë duke u kryer. Pra, problemet

që kanë qëndruar për vite të tëra në sirtarët e qeverive të kaluara kanë filluar të zgjidhen me këtë Qeveri.

"Epoka e re": Megjithatë, koalicioni qeverisës kohët e fundit po ka problem ta krijojë shumicën në Kuvendin e Kosovës dhe si rezultat i kësaj të enjtes nuk ka arritur t'i ratifikojë tri marrëveshje ndërkombëtare të cilat ia mundësojnë Kosovën qasjen për aplikim në fonde prej miliona eurosh.

Berisha: Bazuar edhe në të kaluarën çështjet që kanë qënë në interes të Kosovës, sidomos ato që kanë të bëjnë me procesin integritetit e që është rruga e vetme e Kosovës drejtës së ardhmes nuk duhet të shikohen vetëm nga aspekti politik dhe partiak. Prandaj besoj se partitë opozitare do ta shohin se është me rëndësi që në këtë periudhë të votohen projektligjet që janë pjesë e agjendës evropiane. Miratimi i këtyre ligjeve dhe zbatimi i tyre është në interes të Kosovës dhe qytetarëve të saj. Projektet e IPA-s duhet të votohen me 2/3 e votave në

Sot (e shtunë), në orën 12:00, me ceremoni shtetërore do t'i jepet lamtumira e fundit veprimtarit të çështjes kombëtare,

LAMTUMIRË,

Me intonimin e himnit të Kosovës, të himnit kombëtar dhe me një minutë heshtje, Kuvendi i Kosovës ka mbajtur të premtën seancë përkujtimore kushtuar jetës dhe veprës së Adem Demaçit, i cili vdiq të enjten në Prishtinë, në moshën 82-vjeçare. Në këtë seancë nga përfaqësues të institucioneve të Kosovës, të Shqipërisë dhe të Maqedonisë, u tha se Demaçi ishte ndër figurat më të mëdha të këtyre 100 vjetëve të fundit. Pas seancës përkujtimore, në hollin e Kuvendit të Kosovës kanë vazhduar homazhet në nderim të veprës së Adem Demaçit. Trupi i simbolit të rezistencës kombëtare do të prehet i qetë në Varrezat e Dëshmorëve në Prishtinë

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 27 KORRIK - Veprimtari i çështjes kombëtare, Adem Demaçi, do të varroset sot (e shtunë) me ceremoni shtetërore. Këshilli Organizativ i ceremonisë së varrimit të veprimtarit të shquar Adem Demaçi ka njoftuar qytetarët e Republikës së Kosovës se ceremonia përkujtimore do të mbahet sot (e shtunë) në Sheshin "Skënderbeu", me fillim nga ora 08:30, ku do të ketë fjalime të krerëve institucionalë. Pas përfundimit të ceremonisë përkujtimore, kortezhi, së bashku me qytetarët, do të nisët drejt varrezave të dëshmorëve në Velani. Presidenti i Kosovës, Hashim



Thaçi, ka vendosur që në nderim të figurës së veprimtarit të njohur politik, Adem Demaçi, të shpallë tri ditë zie në Kosovë. Flamuri shtetëror i Republikës së Kosovës është ulur të premtën në gjysmështrizë në të gjitha institucionet shtetërore brenda dhe jashtë vendit. Të premtën, me intonimin e himnit të Kosovës,

hymnit kombëtar dhe me një minutë heshtje, Kuvendi i Kosovës ka nisur seancën përkujtimore kushtuar jetës dhe veprës së Adem Demaçit, i cili vdiq të enjten në Prishtinë, në moshën 82-vjeçare. E pranishme në këtë seancë ishte edhe familja e Demaçit, por edhe përfaqësues ndërkombëtarë. Kryetari i Kuvendit të Kosovës,

Kadri Veseli, në seancën kushtuar veprimtarit të shquar Adem Demaçi, tha se ai ishte ndërgjegjja e lëvizjes kombëtare për çlirimin e Kosovës. Veseli ka thënë se me vdekjen e Adem Demaçit, Kosova ka humbur një prej burrave të mëdhenj që ka dhënë kjo tokë në 100 vjetët e fundit. "I gjithë kombi ynë është në pikëllim. Kemi hum-

bur njërin prej njerëzve të mëdhenj që ka dhënë kjo tokë në 100 vjetët e fundit. Kemi humbur Adem Demaçin, simbolin e gjithë lëvizjes sonë kombëtare për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. Heroin dhe frymëzimin tonë. Dhimbja është e pafund. Por, po aq e pafund edhe krenaria që e patëm këtë burrë të madh, të rrallë e të



Adem Demaçit

BACË!



ngriti zërin e rezistencës e të kryengritjes për liri. Dhe, nuk u ndal e nuk u dorëzua asnjëherë", ka thënë Veseli, duke shtuar se "e burgosën, e izoluan, e dënuan, e ridënuan, 28 vjet pandërprerë. Por, nuk e thyen. Nuk e bënë për vete". "Adem Demaçi e kishte mposhtur frikën nga pushtuesi

dhe me guxim të tij ai e mësoi një popull të tërë ta mposhtë frikën. Këtu nisi liria, sepse një popull që nuk i frikësohet pushtuesit, ai domosdo do ta fitojë lirinë", ka deklaruar Veseli.

Kryeparlamentari Veseli ka thënë se Adem Demaçi ishte nderi i kombit dhe i tillë do të mbetet



Thaçi: Emri, jeta dhe vepra e Adem Demaçit do të jetojnë

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka bërë homazhe të premtën pranë arkivolit të veprimtarit të çështjes kombëtare, Adem Demaçit. Thaçi në një postim në llogarinë e vet në "Facebook" ka treguar për fjalët që i ka shkruar në Librin e Zisë për Demaçin. "Më 26 korrik 2018 shkoi në përjetësi njeriu që u bë simbol i

ndërgjegjes sonë kombëtare, njeriu i qëndrësës, humanizmit dhe fljimit për vlerat supreme të njerëzimit të lirisë, barazisë dhe jetës me dinjitet, Adem Demaçi. Emri, jeta dhe vepra e tij do të jetojnë aq sa do të jetojnë kombi, shoqëria dhe njerëzimi për të cilët ai u shkri një jetë të tërë", ka shkruar presidenti Thaçi.



jashtëzakonshëm të kombit. Një patriot të pashoq. Adem Demaçi ishte i pari ndër të parët në luftën e vështirë e plot sakrificë për çlirim kombëtar. Kur pas vitësh terrori, regjimi jugosllav po kremtonte shtypjen e plotë të rezistencës shqiptare, pikërisht në vitet e errëta '50 të shekullit të kaluar, ishte Adem Demaçi që

Muhamet Mavraj: Është pak nëse një qyteti ia vëmë emrin Adem Demaçi

Muhamet Mavraj, një nga liderët e protestave studentore të vitit 1997, botues i gazetës së përditshme "Epoka e re", ka shprehur ngushëllimet e tij për familjen Demaçi, për vdekjen e veprimtarit të shquar shqiptar Adem Demaçit. Ai ka thënë se ai na nderonte. "Takimi i fundit me Bacën Adem ishte tre muaj më parë, në përvjetorin e shokut tonë, Shashivar Makolli. Iku edhe Baca, një kryelegjendë në vetvete. E njoh aq vite sa ai ishte në burgje. Më shumë e doja sesa e dëgjoja, sepse këshu na mësoi jeta e tij. Nuk e kemi

nderuar sa ai na nderonte. Zor të jetë dikush më i thjeshtë se ai. Më vdiq nëna, Baca erdhi me 30 veta. Më vdiq motra, Baca erdhi me 30 veta. Më vdiq edhe baba, Baca erdhi me 30 veta. As në planin privat, as në të tjerët, kurrë këtij njeriu nuk mund t'i dal hakut. Edhe si komb, sakrificat e tij nuk i kemi vlerësuar dinjitetshëm. Është pak nëse një qyteti na shkon mendja nesër t'i japim emrin e Tij. Ngushëllime familjes Demaçi dhe tërë shqiptarëve që e kanë dashur! Krenar përjetë që ishte i yni!", ka shkruar Mavraj në llogarinë e vet në "Facebook".

përjetë e mot. "Secili nga ne sot ndihet krenar që patëm fatin të jetojmë në epokën e Adem Demaçit. Intelktual e veprimtar politik i nivelit evropian. Ai kurrë nuk kërkoi asgjë për vete. Asgjë. Për të, liria e Kosovës ishte nderimi më i madh. Dhe nëse ka një njeri që me jetën dhe veprën e tij e mishëron më së miri raportin e individit me atdheun, siç shkon ajo thënia e famshme, emblematike 'mos pyet çfarë ka bërë atdheu për ty, por çfarë ke bërë ti për atdheun'. Ky njeri është Adem Demaçi. Po. Një pjesë e historisë së Kosovës është historia e jetës së tij. Faleminderit për gjithçka bërë për atdheun gjatë gjithë jetës tënde, Adem Demaçi", është shprehur Veseli.

Ndërkaq në fjalën e saj nënkryetarja e Kuvendit të Shqipërisë, Vasilika Hysi, ka thënë se nga dita e enjte Kosova dhe shqiptarët nuk janë më si më parë, sepse kanë mbetur pa patriotin dhe kalorësin e paqes. Ajo ka theksuar se Kosova ka humbur një nga frymëzuesit dhe martirët e lirisë së saj. "Sot të gjithë jemi të pushtuar dhe dëshpëruar nga një hidhërim i madh. Prej ditës së djeshme Kosova dhe shqiptarët nuk janë më si më parë, mbetem pa shqiptarin, patriotin, heroin, shkrimtarin, luftëtarin, dijetarin, humanistin, kalorësin e paqes, pa Adem Demaçin. Në emër të kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë, z. Gramoz Ruçi, dhe në emër të

gjithë kolegëve të mi deputetë, sjellë ngushëllimet për këtë humbje të rëndë. Humbëm një njeri të madh dhe të jashtëzakonshëm. Nuk është më midis nesh luftëtari i lirisë dhe i paqes. Kosova humbi një nga frymëzuesit dhe martirët e lirisë së saj. Të qoftë i lehtë dhe i atdheut, miku ynë, Adem Demaçi", ka thënë nënkryetarja e Kuvendit të Shqipërisë, Vasilika Hysi.

Kurse kryetari i Kuvendit të Maqedonisë, Talat Xhaferi, ka theksuar se Demaçi nuk u dorëzua para asnjë sfide. Ai ka shtuar se vepra e tij është vlerësuar nga institucionet vendore dhe ndërkombëtare siç është Parlamenti Evropian. Xhaferi ka thënë se vdekja e Demaçit është humbje e madhe për të gjithë shqiptarët dhe gjithë njerëzimit. Pas seancës përkujtimore, në hollin e Kuvendit të Kosovës kanë bërë homazhe përfaqësues të institucioneve të Kosovës, të nivelit qendror dhe lokal, liderë partish, përfaqësues ndërkombëtarë, përfaqësues nga organizatat e dala nga lufta e UÇK-së, përfaqësues nga shoqëria civile dhe shumë qytetarë. Demaçi, veprimtar politik dhe mbrojtës i të drejtave të njeriut, njihet si simbol i rezistencës në Kosovë për lirinë dhe pavarësinë e saj. Për shkak të pikëpamjeve të tij politike, ai kishte vuajtur një dënim prej 28 vjetësh në burgjet e ish-Jugosllavisë e më pas të Serbisë, andaj shpesh është quajtur "Mandela i Ballkanit".



Nderim simbolit të rezistencës kombëtare, Adem Demaçit (1936-2018)

VDEKJA E TË PAVDEKSHMIT



Agim VINCA

U nda nga jeta Adem Demaçi. Vdiq njeriu që qysh për së gjalli fitoi pavdekësinë.

"Vdekje, kosën paloje", do të thoshte poeti. S'ke ç'i bën një lisi si Demaçi!

Ai bëri për Kosovën dhe kombin shqiptar atë që s'e ka bërë askush tjetër: rezistencën shembullore dhe sakrificën sublime!

Ai ishte frymëzuesi më i madh në luftën tonë të gjatë e të vështirë për liri, që ende s'ka marrë fund. Ai ishte idoli i ditëve tona djaloshare, njeriu që na mësoi si duhet atdheu dhe si luftohet për lirinë e mbrohtësinë e tij.

Brezi im është rritur me emrin e Adem Demaçit, të cilin e kemi mbajtur në zemër dhe ia kemi pëshpëritur njëri-tjetrit edhe atëherë kur s'kemi guxuar ta shqiptojmë publikisht.

Adem Demaçi! Ai është një dhe s'ka të dytë!

Njëzet vjeç shkroi romanin emblemantik "Gjarpit e gjakut", që u botua në vitin 1958, duke dhënë mesazhin e madh: "Jo atyne që janë trima me ngrah gishtin e krimin, por atyne që janë trima me shtri dorën e pajtimit". Duhet t'i shtrijmë dorën njëri-tjetrit për ta mundur armikun.

E burgosën, "në emër të popullit" ("Në emër të cilit popull?", u tha inspektorëve të UDB-së kur e arrestuan në zyrën e "Rilindjes", ku punonte si gazetar dhe e dënuan për "agitacion e propagandë".

Kishte kërkuar në ndeja me kolegët e vet që të organizoheshin në mbrojtje të popullit të cilit i takonin, sepse kjo ishte detyrë e tyre si intelektualë.

Herët, shumë herët, kish guxuar atë që të tjerët nuk guxonin as ta ëndërronin: Luftën për liri kombëtare e dinjitet njerëzor.

Ai, Adem Demaçi, që me kalimin e kohës do ta marrë nofkën "Baca Adem".

Pas daljes nga burgu i parë, ra përsëri në burg, në vitet '60, tani për shkak se kishte formuar organizatën e tij të fshehtë politike "Lëvizja Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve" (LRBSh), të shtrirë në tërë Kosovën, programin e së cilës e pat shkruar vetë, me dorën e tij, duke kërkuar çlirimin e Kosovës e të viseve të tjera shqiptare në ish-Jugosllavi dhe bashkimin e tyre me "Nanën Shqipni".

Ç'herezi!

Nuk u pendua kurrë, nuk u ligështua kurrë, edhe në pranga e brenda mureve të qelisë ai ishte i lirë.

E sakrifikoi talentin e shkrimtarit të dorës së parë për hir të kauzës kombëtare. Pa asnjë dilemë e mëdyshje. Pa u ankuar kurrë për vete.

Populli ishte ylli i tij polar. Dhe mbarë njerëzimi, sepse ai ishte atdhetar i madh, por edhe humanist i madh.

Kur doli nga burgu i tretë, pas njëzet e tetë vjetësh, në prill të vitit 1990, deklaroi: "Dola nga burgu i vogël dhe hyra në burgun e madh

prej dy milionë njerëzish".

Kosova vuante si gjithnjë, madje edhe më keq se më parë, nën thundrën e një regjimi kriminal. Atdhetar, veprimtar, lider shpirtëror e politik, publicist dhe shkrimtar, mësues dhe luftëtar, vizionar edhe kur dukej utopik, Adem Demaçi është një institucion më vete.

Hazërxehevap dhe me talent të lindur oratorik, ai shkëlqeu në intervista dhe duele televizive jo vetëm në Prishtinë, por edhe në Beograd, Zagreb, Lubjanë e gjetkë, brenda dhe jashtë.

Kurrë s'i shkruante fjalimet, fliste pa tekst dhe nuk ngecte pothuajse kurrë.

Mendje brilante, që fliste rrjedhshëm dhe troç (ashtu siç edhe shkruante) edhe para Zotit edhe para djallit. Kudo. Dhe në çdo kohë.

I vogël me trup, por i madh me zemër e shpirt.

Ishte i tëri guxim e vendosmëri, por edhe dije e dashuri.

"Dashuri, energji, krijimtari". Kjo ishte formula e tij.

Nuk e njihte rrezikun, nuk i tutej vdekjes.

Ai, Adem Demaçi, Biri i madh i një kombi të lashtë, por me fat tragjik, që rrallë e lindin shekujt. Baca na la! Iku në amshim. Shkoi te ai Ademi tjetër dhe shokët e tij, dalzotësit e Kosovës.

Nuk kemi ditur ta nderojmë sa e meritonte gjatë jetës.

Do të dimë vallë ta bëjmë këtë pas vdekjes?

Strugë, 27 korrik 2018

Merren masa shtesë për parandalimin e aksidenteve

Të premtën është mbajtur takimi i Këshillit për Siguri në Trafikun Rrugor, me qëllim të marrjes së masave adekuate për uljen e aksidenteve në trafikun rrugor, e sidomos të atyre me fatalitet. Në këtë takim u diskutua për aksidentet në trafikun rrugor dhe për veprimet për reduktimin e tyre

EPOKA ERE

Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 27 KORRIK - Me inicim të ministrit të Punëve të Brendshme, Bejtush Gashi, të premtën është mbajtur takimi i radhës i Këshillit për Siguri në Trafikun Rrugor. Në këtë takim ministri Gashi ka bërë me dije se Ministria e Punëve të Brendshme në bashkëpunim me programin ICITAP është duke punuar për implementimin e një Vlerësimi të Veçantë të Zbatimit të Ligjit në Trafik me qëllim të identifikimit të saktë të shkaqeve në trafik, marrjes së masave dhe veprimeve përkatëse si dhe parandalimit më efikas të aksidenteve në trafik. Ai ka thënë se për implementimin e suksesshëm të këtij vlerësimi nevojitet që Policia e Kosovës së bashku me ekspertët in-

hinerë të infrastrukturës rrugore dhe ekspertët e tjerë, fillimisht të trajnohen dhe më pas të bashkëveprojnë ngushtë mes vete. "Si ministër i Punëve të Brendshme dëshiroj ta shpreh shqetësimin tim për gjendjen aktuale të sigurisë në trafikun rrugor, referuar numrit të aksidenteve në trafikun rrugor, përfshirë këtu një numër të konsiderueshëm të aksidenteve me fatalitet. Duke iu referuar situatës aktuale lidhur me aksidentet në trafik dhe pasojat e tyre, Ministria e Punëve të Brendshme përmes Policisë së Kosovës ka marrë masa serioze shtesë, me qëllim të ngritjes së nivelit të sigurisë, parandalimit të aksidenteve të trafikut dhe zbatimin e ligjshmërisë në funksion të menaxhimit dhe kontrollit të trafikut rrugor. Për këtë qëllim Policia e Kosovës nga data 24 korrik 2018 ka

themeluar "Task Forcën" për parandalimin e aksidenteve në trafikun rrugor", ka thënë ministri Gashi. Ai ka vlerësuar lart rolin e Këshillit për Siguri në Trafikun Rrugor.

Ndërsa ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, ka thënë se aksidentet në komunikacionin rrugor paraqesin brengë serioze të të gjitha institucioneve dhe qytetarëve të Kosovës. "Përvoja ndërkom-bëtare ka treguar se pa renditjen e sigurisë rrugore si prioritet i lartë dhe pa koordinim të të gjitha institucioneve nuk mund të kemi sukses në luftën kundër aksidenteve rrugore", ka thënë ministri Lekaj, duke shtuar se duke u sjell në pajtim me ligjet dhe rregullat e trafikut rrugor secili mund të japë kontribut në dobi të përmirësimit të sigurisë së trafikut rrugor. "Ne kemi paraparë disa rekomandime siç



janë: Masat e menjëhershme nga Policia e Kosovës dhe që do të mbështeten nga Ministria e Infrastrukturës me kapacitetet e veta ligjore e profesionale. Policia e Kosovës do ta informojë Ministrinë e Infrastrukturës lidhur me shkaktarët e aksidenteve, sidomos të atyre me fatalitet që kanë ndodhur brenda këtij viti. Formimi i një grupi të përbashkët ekspertësh të institucioneve të përfshira drejtpërdrejt në sigurinë rrugore, për rishikim të strukturës së faktorëve kryesorë të shkakut të aksidenteve", ka thënë Lekaj.

Sipas të dhënave të Policisë së Kosovës, numri i përgjithshëm i aksidenteve gjatë periudhës janar-qershor 2018 krahasuar me numrin e përgjithshëm të aksidenteve gjatë periudhës së njëjtë të vitit të kaluar është më i vogël për (-)13.25%. Për periudhën e njëjtë krahasuese, edhe numri i aksidenteve me fatalitet ka shënuar rënie prej (-)19.61%. Po ashtu, edhe numri i aksidenteve me dëme materiale ka shënuar rënie për (-)20.65%. Ndërsa numri i aksidenteve me lëndime trupore ka shënuar ngritje prej (+)0.46%.

Klubi i Prodhuesve: Vendimet kundërthënëse të Qeverisë po i sjellin dëme prodhuesit vendor

EPOKA
ERE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 27 KORRIK - Klubi i Prodhuesve të Kosovës (KPK) ka reaguar ndaj veprimeve kundërthënëse të Qeverisë së Kosovës në lidhje me vendimet për ndërmarrjen e masave të përkohshme mbrojtëse ndaj produkteve të importuara në Kosovë nga shtetet fqinje.

KPK-ja ka mirëpritur vendimin e Qeverisë për marrjen e masave të përkohshme mbrojtëse ndaj produkteve të qumështit nga

Bosnja dhe Hercegovina, por ka vlerësuar se moszbatimi i këtij vendimi për tre muaj ka qenë i dëmshëm për prodhuesit vendorë. Po ashtu, KPK-ja ka shprehur shqetësimin për vendimin për tërheqjen e masave mbrojtëse të përkohshme ndaj shumë produkteve të pemëve dhe perimeve ndaj vendeve fqinje disa ditë pas marrjes së vendimit për aplikimin e këtyre masave. "Vazhdimi i këtyre masave për vetëm shtatë përbën një mbrojtje minimale për prodhuesit vendorë të cilët po pësojnë

dëme të pariparueshme. KPK-ja cilëson se vonimi apo anulimi i vendimeve nuk e ndihmon zhvillimin ekonomik të Kosovës. Këto veprime nuk tregojnë seriozitet karshi kontributit të prodhuesve vendorë dhe përpjekjes së vazhdueshme për arritjen e bilancit tregtar në vend", është thënë në reagimin e KPK-së. KPK-ja i ka bërë apel Qeverisë që çështje të tilla ekonomike t'i adresojë me seriozitet dhe që vendimet për masat mbrojtëse të përkohshme të mos ndryshohen apo anulohen.



Reçica vazhdon përpjekjet për krijimin e vendeve të reja të punës

PRISHTINË, 27 KORRIK (ER) - Në kuadër të bashkëpunimit me UNDP-në dhe me qëllim të zgjerimit të mundësive në masat aktive të tregut të punës, ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, ka zhvilluar të premtën disa takime me përfaqësues të Zyrës Regjionale të UNDP-së për Euro Azi, me seli në Stamboll.

Reçica ka bërë me dije se bashkë me udhëheqësen e ekipit mbështetës të zyrës, Matilda Dimovska, kanë diskutuar rreth ndërtimit të kapaciteteve dhe implementimit të përbashkët të projekteve për rritje të punësueshmërisë në Kosovë, sidomos të rinjve, nëpërmjet masave aktive të tregut të punës.

Po të premtën ministri Reçica ka

takuar edhe Sahba Sobhani nga Qendra Ndërkombëtare për Zhvillim të Sektorit Privat, me të cilin ka biseduar rreth përvojave të UNDP-së të realizuara në vende të tjera si dhe rreth bashkëpunimit me sektorin privat për aftësimin, riaftësimin e të rinjve, me qëllim krijimin e vendeve të reja të punës, duke përbushur nevojat e tregut të punës.



Aeroporti i Prishtinës, trajnime të autorizuar nga IATA dhe Swiss

EPOKA
ERE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 27 KORRIK - Në mënyrë që kompanitë të jenë në hap me ndryshimet e shpeshta në botën e aviacionit, që kryesisht rezultojnë si pasojë e zhvillimeve të avancuara teknologjike, është më se e nevojshme që stafi të trajnohet në përputhje me ndryshimet e arritura. Për këtë, Qendra e Trajnimeve e kompanisë "Limak" që menaxhon ANP "Adem Jashari" tanimë është autorizuar nga Shoqata

Ndërkombëtare e Transportit Ajror - IATA për ofrimin e shërbimeve trajnuese ndaj anëtarëve të tjerë të industrisë së aviacionit. Nëntë kurse të ndryshme të certifikuar nga IATA ofrohen nga instruktorë të specializuar të ANP "Adem Jashari" me përvojë në këtë fushë ashtu që të interesuarve t'u ofrohen shërbime të kualitetit sa më të lartë.

Ndërsa Aeroporti i Prishtinës ofron edhe trajnim të aprovuar nga kompanitë ajrore Swiss International Air Lines dhe

Swiss European Air Lines. Trajnimet mund të realizohen në hapësirat e ANP "Adem Jashari" dhe në lokacionin ku të interesuarit kërkojnë. Shoqata Ndërkombëtare e Transportit Ajror është një ndër organizatat më të rëndësishme të aviacionit e themeluar në vitin 1945 dhe ka për qëllim promovimin e sigurisë, besueshmërisë dhe ofrimin e shërbimeve të favorshme për të gjithë udhëtarët e trafikut ajror, duke u mbështetur në bashkëpunimin ndërmjet kompanive ajrore.



Ministri Rikalo: Do të ndërmarrim masa për tejkalimin e problemeve në sektorin e mjedrës

PRISHTINË, 27 KORRIK (ER) - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural do të ndërmarrë hapa konkretë për tejkalimin e vështirësive të krijuara ditët e fundit në sektorin e mjedrës. Krahas kësaj, MBPZHR-ja do ta shqyrtojë edhe mundësinë për ta ndryshuar metodologjinë e subvencionimit të këtij sektori që nga viti i ardhshëm. Këto u konstatuan të premtën, në takimin që ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe

Zhvillimit Rural, Nenad Rikalo pati me kryetarin e Shoqatës së Kultivuesve të Mjadrës, Sami Uka.

Rikalo ka theksuar se do t'i përkrahë në vazhdimësi kultivuesit e mjedrës, duke premtuar se do t'i ndërmarrë të gjitha masat për ta tejkaluar krizën e shkaktuar gjatë këtyre ditëve në sektorin e mjedrës. Ai ka theksuar se do të pritë derisa të bëhet grumbullimi i mjedrës këtë vit, ku do të kenë edhe të dhënat për sasinë e

mbjellë të kësaj kulture bujqësore që, sipas tij, në bazë të kësaj të vendoset edhe për mënyrën e përkrahjes së sektorit të mjedrës, në të cilin gjatë këtij viti janë paraqitur probleme.

Ndërkaq kryetari i Shoqatës së Kultivuesve të Mjadrës, Sami Uka, ka falënderuar ministrin për gatishmërinë e tij për bashkëpunim dhe për përkrahjen që po u jep në vazhdimësi këtyre prodhuesve me qëllim të tejkalimit të problemeve.



Mbi 1 000 çifte u shkurorëzuan në Kosovë gjatë vitit të kaluar

Në vitin 2017 në Kosovë janë raportuar të shkurorëzuar 1 072 çifte. Prej tyre, meshkuj të përkatësisë shqiptare ishin 97.5 për qind, serbe 0.3 për qind, turke 0.2 për qind, boshnjake 0.6 për qind, rome, ashkali dhe egjiptiane 0.7 për qind dhe të tjerë 0.7 për qind

PRISHTINË, 27 KORRIK (ER) - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar "Statistikat e Shkurorëzimeve në Kosovë" për vitin 2017. Të dhënat në këtë publikim janë paraqitur sipas bazës së grumbullimit të të dhënave administrative për vitin 2017 nga gjykatat themelore të Kosovës, ku janë grumbulluar gjithsej 1 072 fleta statistikore për shkurorëzime SHK-1. Këto të dhëna tregojnë se në Kosovë në vitin 2017 janë raportuar të shkurorëzuar 1 072 çifte. Prej tyre, meshkuj të përkatësisë shqiptare ishin 97.5 për qind, serbe 0.3 për qind, turke 0.2 për

qind, boshnjake 0.6 për qind, rome, ashkali dhe egjiptiane 0.7 për qind dhe të tjerë 0.7 për qind.

Femrat e shkurorëzuara sipas përkatësisë etnike ishin: shqiptare 84 për qind, serbe 0.5 për qind, turke 0.2 për qind, boshnjake 0.8 për qind, rome, ashkallike dhe egjiptiane 0.8 për qind dhe të tjerë 13.7 për qind. Sipas kohëzgjatjes së martesës, dominon viti i parë me 13.4 për qind, viti i dytë me 13.2 për qind dhe me më pak se një vit 9.6 për qind e të shkurorëzuarve.

Shkurorëzimet sipas grupmoshave, dominonin femrat e moshës 25-29-vjeçare me 230



shkurorëzime, ose 21.5 për qind, kurse te meshkujt dominonte moshja 30-34 vjeç me 228, ose 21.3 për qind. Sipas përgatitjes shkollore, dominojnë femrat dhe

meshkujt me shkollë të mesme. Numri i femrave të kësaj kategorie është 332, ose 31 për qind, kurse e meshkujve 390, ose 36.4 për qind.

Numri më i madh i bashkëshortëve të shkurorëzuar janë pa fëmijë me 68.9 për qind, pastaj vijnë me dy fëmijë me 11.2 për qind dhe me tre fëmijë me 9.1 për qind.

U nderua 20-vjetori i 'Betejës së Zharrës'

JUNIK, 27 KORRIK (ER) - Nën përkujdesjen e kryetarit të Komunës së Junikut, Agron Kuçi, është mbajtur të premten akademi përkujtimore për nder të 20-vjetorit të betejës së lavdishme 'Beteja e Zharrës'. Kryetari Agron Kuçi ka bërë me dije se 20 vjet më parë në vendin e quajtur Zharre në rrethinën e Junikut, në afërsi të fshatit Gjocaj, grupet vëzhguese të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të cilat po patrullonin në atë pjesë hasën në hordhitë e armikut të cilët kishin planifikuar që në mënyrë të fshehtë t'i marrin pikat strategjike të Junikut, të cilat ishin bërë të pathyeshme. Sipas tij, në atë betejë u shpartalluan të gjitha njësitë e armikut nga UÇK-ja, duke u shkaktuar humbje shumë të mëdha, ndërsa nga forcat tona



çlirimtare ranë dëshmorë: Arif Gjocaj, Shkëlzen Gacaferri, Avdyl Jasiqi dhe u plagosën shumë ushtarë të tjerë. "Sot ne i kujtojmë me dinjitet dhe

përulemi para veprës së tyre. Lavdi për jetë dhe mot të gjithë heronjve, dëshmorëve, martirëve të Junikut dhe Kosovës", ka thënë Kuçi.

KGJK-ja mbështet Rrjetin e Grave të Kosovës

PRISHTINË, 27 KORRIK (ER) - Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), Nehat Idrizi, ka pritur të premten në takim përfaqësueset e Rrjetit të Grave të Kosovës (RrGK) në krye me drejtoreshën ekzekutive të Rrjetit të Grave të Kosovës, Igballe Rogova. RrGK-ja ka për mision dhe ka vizion për një shoqëri të shëndoshë dhe pa dhunë, i cili rrjet vazhdimisht punon për ta luftuar dhunën me bazë gjinore dhe diskriminimin gjinor.

Kryesuesi Idrizi u shpreh i gatshëm të ndihmojë dhe të bashkëpunojë me RrGK-në për mbledhjen e të dhënave lidhur me rastet e dhunës në familje, ngacmimit seksual dhe të diskriminimit gjinor në punë, pasi që KGJK-ja ofron shërbime gjyqësore të paanshme për të gjithë qytetarët e Kosovës, njëkohësisht punon edhe për ngritjen e kapaciteteve të gjyqtarëve për mbrojtjen e personave që kanë përjetuar dhunë dhe diskriminim në baza gjinore.



KEDS-i zgjeron rrjetin për 225 familje në Dragobil të Malishevës



MALISHEVË, 27 KORRIK (ER) - Janë 225 familje nga fshati Dragobil i Malishevës që do të kenë energji elektrike shumë më kualitative dhe stabile nga investimi i radhës nga KEDS-i. Me këtë investim tani është rritur edhe cilësia e jetës së banorëve në këto anë. Gjatë zbatimit të këtij projekti KEDS-i ka vendosur dy trafo të reja me kapacitet prej 250 kVA

dhe janë riparuar tri trafot ekzistuese që plotësojnë nevojat energjetike për konsumatorët e kësaj ane. Shtyllat e vjetra të drurit janë zëvendësuar me të reja të betonit dhe janë hequr komplet përcuesit e zhveshur (pa izolim) që kanë qenë të rrezikshëm për banorët dhe janë zëvendësuar me kablllo bistikë të izoluar, ku shkalla

e rrezikshmërisë është zero, natyrisht se edhe janë zvogëluar humbjet teknike. Ky investim është i mirëseardhur për banorët e fshatit, sidomos për bizneset. KEDS-i po vazhdon investimet dhe tashmë ka rregulluar tensionin dhe infrastrukturën energjetike për shumë vendbanime anekënd Kosovës.

RECIPROCITET APO ASOCIACION TË KOMUNAVE?

Çfarë fitojmë me reciprocitetin deri në ridefinim të kufijve sot dhe çfarë humbim me asociacionin që do të çojë në ndarje nesër?



Valon MURATI

1. Kosova në të gjitha fazat e dialogut me Serbinë, që prej vitit 2011, është futur në to e papërgatitur, e përçarë dhe pa një platformë të qartë. Institucionet tona kanë pranuar të futen në dialog në të cilin është folur vetëm për Kosovën dhe vetëm për pozitën e serbëve në Kosovë. Bisedimet në vend se të shërbejnë për zgjidhjen e problemit shqiptar-serb, i kanë shërbyer hapjes së rrugës për integrim më të shpejtë të Serbisë në BE, por pa prekur asnjëherë thelbin e problemeve që ekzistojnë në mes të dy vendeve dhe popujve. Rrjedhimisht, të drejtat dhe fati i shqiptarëve në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë, është injoruar tërësisht. Në këtë drejtim, shumë pak kanë dalluar PDK-ja, LDK-ja dhe AAK-ja. Në anën tjetër, opozita, kryesisht e përfaqësuar nga VV-ja, ka bërë dëmin e saj, duke refuzuar tërësisht bisedimet me Serbinë për një kohë të gjatë, duke lënë kështu qeverinë që e vetme dhe e papërgjegjshme të vazhdojë t'i udhëheqë bisedimet, pa një koncept të qartë. Kohët e fundit, ndonëse kemi një ndryshim qëndrimesh të subjekteve politike, ajo që nuk dallon është se ato janë të paafta për të ndërtuar një platformë politike dhe debatin e kanë përqendruar se kush do t'i udhëheqë ato bisedime. Pozita është e paaftë të prodhojë konsensus politik, jo vetëm me të tjerët, por as në mes vete, gjë që u dëshmuar nga skenat groteske të javës së kaluar ku të gjithë përfaqësuesit e saj shkuan në Bruksel. LDK-ja tash, e frikësuar nga rezultati i bisedimeve dhe duke mos qenë unike nga brenda, refuzon të jetë pjesë e bisedimeve, me arsyetimin e refuzimit të udhëheqjes së bisedimeve nga presidenti, por, në të vërtetë, më shumë për shkak të frikës se si do të reagojë elektorati dhe për shkak të mundësisë që VV-ja të fitojë

vota me politikën e refuzimit të bisedimeve dhe rezultateve të tyre. Në anën tjetër, VV, duke e pasur të qartë mundësinë e fitoreve elektorale nga mosprania në bisedime dhe mospranimi i rezultateve të tyre, vendos çdoherë kushte të ndryshme qoftë për Serbinë, qoftë për partitë e tjera dhe institucionet e Kosovës për të qenë pjesë e bisedimeve. E rëndësishme është që asnjëra palë nuk e shtron seriozisht çështjen e ndërtimit të një platforme të përbashkët.

2. Në këtë zallahi politike shfaqet si gogol nate, e frikshme e tmerruese, mundësia e ndarjes së Kosovës, apo edhe e shkëmbimit të territoreve në mes të Kosovës e Serbisë, si pjesë e një marrëveshjeje finale. Deri më tani shumica e shteteve kryesore aleate kanë qenë kundër kësaj ideje. Shfaqja e disa dyshimeve nga politika e ShBA-së kohëve të fundit e rindezi këtë temë edhe njëherë. Përkundër që kjo temë është shtruar deri më tani jozyrtarisht, unë jam goxha i bindur se është më shumë një mekanizëm frike për të përgatitur terrenin për variantin më të keq të marrëveshjes për Kosovën: implementimin e asociacionit me kompetenca shtesë ekzekutive. Sigurisht që ky variant do të mund të quhej përfundimtar vetëm në këtë fazë të zhvillimeve të raporteve të Kosovës me Serbinë, por, në të vërtetë, nuk do të zgjidhte asgjë në këto raporte. Serbia, më së shumti, do ta hiqte Kosovën nga kushtetuta, duke ia hapur vetes rrugën për integrim në BE, por nuk do të detyrohej ta njihje Kosovën. Ne, më së shumti, ndonëse edhe për këtë jam jashtëzakonisht skeptik, do të mund të pranoheshim në OKB, por entuziazmi i pranimit aty shpejt do të zëvendësohej me vuajtjen nga mosfunksionaliteti i shtetit tonë. Të mos harrojmë se pjesë të OKB-së janë edhe shtetet jofunksionale si Bosnja e Hercegovina, Sudani Jugor etj. Ndërsa, një shteti funksional si Zvicra, asgjë nuk i ka penguar të jetë ashtu si është, efikas e i zhvilluar, model për të tjerët, edhe pa qenë anëtare e OKB-së deri në vitin 2006.

3. Lëvizja për Bashkim, që me platformën e vitit 2010, e përmes deklaratave edhe më

herët, ka theksuar se nuk ka rrugë tjetër për zgjidhjen e problemeve të mbetura ndërmjet Kosovës dhe Serbisë përveç dialogut politik. Ne kemi kërkuar që ai dialog të zhvillohet duke u bazuar në parimin e reciprocitetit. Atë që kërkojnë serbët në Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan t'u jepet edhe shqiptarëve në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë. Ky parim do të duhej të shkonte deri në ridefinimin e kufijve duke u bazuar në parimin e vetëvendosjes së popujve. Lëvizja për Bashkim, në kuadër të platformës së saj, ka theksuar se në këto bisedime nuk duhet të përfshihet pjesa veriore e qytetit të Mitrovicës, sepse nga aty janë dëbuar mbi 12.000 shqiptarë me dhunë. Kemi kërkuar atëherë, siç kërkojmë edhe sot, që urgjentisht të hartohen politika për kthimin e shqiptarëve në pronat e veta në veri të Mitrovicës. Më vonë, kemi theksuar se nëse parimi i reciprocitetit shtrihet jashtë tri komunave të veriut të Kosovës dhe tri komunave shqiptare të Kosovës Lindore, atëherë reciprociteti mund të shtrihet duke barazuar të drejtat e shqiptarëve në Serbi me ato të serbëve në Kosovë. Kjo do të duhej të shkonte deri aty, sa shqiptarët të kenë vende të garantuara në Kuvendin e Serbisë, të kenë fuqinë e zbatimit të votës së dyfishtë për ndryshimet kushtetuese, të kenë një fond të veçantë për zhvillim i cili ndahet nga grumbullimi i të hyrave nga doganat, si dhe të kenë të drejta të tjera që kanë serbët në Kosovë. Në situatën në të cilën gjendemi, hartimi i një platforme që do të vendoste parimin e reciprocitetit në bisedimet me Serbinë do të ishte jetike për Kosovën.

4. Çka do të sillte sot një politikë e reciprocitetit në të drejtë, e që do të përfundonte në ridefinim të kufijve: a) Shteti i Kosovës do të funksionalizohej dhe do të çlirohej nga barra e panevojshme e koncepteve të privilegjeve të pakicave përmes votës së dyfishtë. Rrjedhimisht, republika jonë do të kishte një kushtetutë më funksionale, në përputhje me interesat e Kosovës, por njëkohësisht do të përfaqësoje më mirë identitetin kombëtar shqiptar, duke kultivuar të drejtat e pakicave

dhe ato të njeriut dhe do të krijonte mundësi për më shumë lojalitet të të gjithë qytetarëve ndaj shtetit të Kosovës;

b) Shteti i Kosovës do të çlirohej nga mundësia që Serbia të prodhonte jostabilitet të vazhdueshëm përmes një aranzhimi kushtetues të pafavorshëm për shumicën shqiptare, si dhe përmes popullatës serbe të përqendruar në një territor homogjen në veri;

c) Shteti i Kosovës do të rriste gjasat për të ruajtur pjesën veriore të qytetit të Mitrovicës dhe të sigurojë që territoret shqiptare në Kosovën Lindore të mos reduktohen përmes shpërnguljes graduale, por të bëhen pjesë e Republikës së Kosovës;

d) Shteti i Kosovës do të arrinte të shtrinte sovranitetin në tërë territorin dhe ta ushtronte atë pa asnjë problem. Serbët në brendësi të Kosovës do të gëzonin të gjitha të drejtat më të larta të pakicave sipas standardeve ndërkombëtare dhe do të shndërroheshin në qytetarë luajalë të Kosovës;

e) Shteti i Kosovës do të zgjidhte problemet me Serbinë dhe do të vendoste bazat për përqendrim në temat zhvillimore;

f) Do të krijoheshin kushtet për një referendum ku qytetarët do të deklaroheshin për një bashkim të mundshëm me Republikën e Shqipërisë;

g) Do të krijoheshin kushtet për normalizim të marrëdhënieve me Serbinë dhe për vendosjen e bazave për një pajtim shqiptar-serb si parakusht i rëndësishëm i stabilitetit rajonal.

5. Çka do të sillte një politikë e pritjes, e krijimit të asociacionit dhe me mundësi që më vonë, në rrethana më të favorshme për Serbinë, të bëhej ridefinimi i kufijve, e që realisht do t'i ngjante kryesisht ndarjes së Kosovës: a) Krijimi i një asociacioni të komunave serbe me mundësi të kompetencave ekzekutive, jo vetëm në arsim, shëndetësi, por edhe në menaxhimin e aseteve publike dhe pasurive natyrore; b) Ky asociacion, i kombinuar me privilegjet kushtetuese bllokuese, që sot i gëzon pakica serbe, do ta bënte shtetin tonë krejtësisht jofunksional; c) Serbia do ta bënte fakt të kryer vendosjen e kufirit etnik në lumin Ibër si qëllim strategjik të

saj, në mënyrë që në çfarëdo rrethanash të ardhshme, pjesë e ridefinimit të kufijve të jetë edhe pjesa veriore e Mitrovicës; d) Serbia ndërkohë do të shtonte presionin për të larguar gradualisht shqiptarët nga Medvegja, Bujanoci dhe Presheva, në mënyrë që në një ridefinim të ardhshëm të kufijve, Kosova të merrte vetëm një pjesë të Preshevës; e) Kjo situatë do të zgjaste agoninë e Kosovës, do të rriste nacionalizmat e të dy popujve, dhe do të shpërqendronte vëmendjen e qeverive të ardhshme të Kosovës nga zhvillimi i vendit, duke e përqendruar vëmendjen në krizat e herëpashershme që do t'i krijonte si i kombinuar mekanizmi i privilegjeve kushtetuese dhe ai i asociacionit.

6. Në këtë situatë nuk ka zgjidhje tjetër përveçse të gjitha forcat politike shqiptare në Kosovë të ulen dhe të hartojnë një platformë unike për bisedimet me Serbinë. Është jetike të mos mbesim peng i parimeve se si është ndërtuar shteti i Kosovës, pra i parimeve ahtisariane. Këto parime, për fat të keq, të bëra si një kompromis i madh me Serbinë, jo vetëm që nuk e zbutën Serbinë, por i dhanë dorë asaj që ta destabilizojë Kosovën në vazhdimësi. Atëherë kur do të çlirohemi nga zinxhirët mendorë të këtyre parimeve, menjëherë do ta kuptojmë se e vetmja rrugë është vendosja e parimit të reciprocitetit me Serbinë në një platformë të ardhshme, të menjëhershme. Rrjedhimisht, ky parim do të duhej të përfshinte të drejtat e shqiptarëve në Preshevë, Bujanoc e Medvegjë dhe të serbëve në Leposaviq, Zveçan e Zubin-Potok, ose të gjithë shqiptarëve që jetojnë në Serbi me ato të serbëve në Kosovë. Finalja e një qasjeje të tillë do të mund të dërgonte në një marrëveshje drejt ridefinimit të kufijve duke respektuar vullnetin e popujve përkatës. Këtu nuk ka asgjë frikësuese. Për më tepër, do t'i jepte fund një konfliktit më shumë se njëshekullor dhe do të hapte rrugë të reja për zhvillimin e të dy vendeve e popujve. Të rrezikshme e frikësuese janë "zgjidhjet" e imponuara të cilat kurdoherë mund të shpërthejnë!

(Autori është kryetar i Lëvizjes për Bashkim)

(Me rastin e vdekjes së simbolit të rezistencës sonë kombëtare, 26. 7. 2018)

Filozofia dhe etika politike e Ad

Dr. Sabri KIÇMARI

Në jetën e kombeve lindin përfaqësues që shndërrohen në aktorë të vetëkuptueshëm dhe të natyreshëm të tij. Një rol të tillë mund ta luajnë vetëm individë të veçantë, të cilët me filozofinë e tyre politike krijojnë themelet e luftës për liri, paqe dhe mirëqenie. Maks Veberi individët e tillë i definoi si udhëheqës karizmatikë. Legaliteti dhe legjitimiteti i tyre bazohet në tipare personale, që ka si rrjedhim një identifikim të vetëkuptueshëm të njerëzve me qëllimet dhe vizionet e tyre, të bazuara në kontributin e jashtëzakonshëm për liri, paqe dhe mirëqenie. Numri i personave të tillë që shndërrohen në individ-aktor në mesin e shqiptarëve është fare i vogël. Adem Demaçi është i tillë. Ai është simbol që sakrifikoi për lirinë kundër tiranisë, për barazinë kundër pabarazisë, për paqen kundër dhunës, për pajtimin kundër hakmarrjes.

Adem Demaçi me filozofinë e tij politike të vetëmohimit krijoi një frymë politike. Kjo frymë është bartur te ne, gjenerata e re e bashkëveprimtarëve të tij nëpër kohë. Ajo është parë si feniks, që ka bërë dritë edhe në netët më të errëta të pushtimit. Ajo nuk është shuar dhe nuk shuhet! Ka mbetur e tillë pavarësisht individëve. Fryma e lirisë, republikës dhe pavarësisë janë të pashlyeshme nga qenia jonë.

1. Filozofia politike është një disiplinë e filozofisë, e cila studion principet dhe normat e rendit shoqëror. Si disiplinë normative ajo merret edhe me kuptimin, shpjegimin dhe kritikën e veprimit politik. Detyrë e saj është të përcaktojë shkallën e legjitimitetit dhe drejtësisë së një rendi shoqëror. Fokus i saj është veprimi politik në një shoqëri, komb, shtet ose nga një aktor politik, duke u përqendruar në vështrimin kritik të rrethanave, mënyrës, dhe normave të veprimit. Ne do të përqendrohemi në këtë rast në veprimin politik të një aktori karizmatik të kombit shqiptar, Adem Demaçit. Fryma politike e krijuar nga Adem Demaçi është e orientuar drejt tri ideve themelore: idesë së kombit, lirisë dhe barazisë. Këto tri ide janë shoqëruar te ai vazhdimisht me një mal idesh të tjera politike si drejtësia, të drejtat e njeriut, paqja, mirëqenia, pajtimi, patriotizmi, idealizmi etj. Përsiatjet e tij filozofike politike dëshmojnë për një kokë gjeniale plot ide. Absorbimi i këtyre ideve ishte detyrë e gjeneratës sonë, por mbetet edhe detyrë e gjeneratave që vijnë. Kjo frymë fiton në peshë sidomos nëse qytetari i Kosovës e rikthen për një moment vëmend-

jen nga e kaluara jo e largët kur: në Kosovë nuk kishte liri dhe qytetarët vuanin nën thundrën e një pushtimi të egër antinjerëzor, fitimi i lirisë ishte synim i të gjithë qytetarëve; në Kosovë nuk kishte paqe dhe lufta për çlirim ishte bërë i vetmi mjet për mbrojtjen e jetës dhe të dinjitetit njerëzor, qytetar e kombëtar - vendosja e një paqeje të qëndrueshme ishte qëllimi i luftës çlirimtare; në Kosovë nuk kishte barazi, sepse pakica e shtypte mizorisht shumicën - vendosja e barazisë së të gjithë qytetarëve ishte imperativ i shumicës dërmuese të qytetarëve; në Kosovë nuk kishte demokraci, sepse qytetarëve nuk u lejohej të vendosnin vetë e lirshëm për sistemin e tyre politik, për përfaqësuesit e tyre, për të ardhmen e tyre vendosja e demokracisë ishte bërë qëllim i pashmangshëm për evitimin e padrejtësisë.

Kombi është një fenomen dinamik historik. Rrënjët e kombit janë prejardhja dhe gjuha e përbashkët. Por, karakteri i kombit zhvillohet përmes historisë, kulturës dhe letërsisë së përbashkët, pastaj sistemit zakonor dhe atij të së drejtës. Shprehitë komplementare të komunikimit të një kombi rrjedhin nga tiparet e përbashkëta të anëtarëve të tij, nga të cilat pastaj rrjedh një identitet kolektiv, i cili në të shumtën e rasteve forcohet nga besimi për një prejardhje të përbashkët. I vetëdijshëm se kombi paraqet fuqi universale, politike, kulturore, shpirtërore dhe ekonomike, Adem Demaçi, që në hapat e parë të veprimit të tij politik, do të punojë në arritjen e shkallës më të lartë të zhvillimit të identitetit kombëtar shqiptar përmes një përbashkësie të qëndrueshme shtetërore. Demaçi e sheh si interes strategjik të kombit shqiptar integrimin. Forcimi i shtetit të Shqipërisë dhe Kosovës, bashkimi dhe integrimi i tyre në Bashkimin Evropian dhe në NATO sipas tij janë pjesë e një qëllimi themelor strategjik të kombit shqiptar: maksimalizimin e fuqisë ekonomike, politike, kulturore dhe rritjen e sigurisë, mirëqenies dhe paqes.

Liria e individit dhe liria e përgjithshme janë strumbullari i filozofisë politike të Adem Demaçit. Ai është mbështetës i jashtëzakonshëm i lirisë së individit konform koncepteve të filozofit anglez John Stuart Mill. Menjëherë pas daljes nga burgu merr përsipër mbrojtjen e të drejtave të njeriut përmes Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut. Në fjalën e tij para Parlamentit Evropian, me rastin e pranimit të Çmimit Saharov, ai do të angazhohej fuqishëm për lirinë e fjalës si hap i parë dhe i domosdoshëm drejt demokracisë: "Pa fjalë të lirë s'ka dialog. Pa dialog nuk mund të zbulohet e vërteta. Kurse pa të vërtetën nuk ka progres".

Por, Adem Demaçin për aq sa mund ta cilësojmë si mbështetës të idesë së lirisë së Millit, po aq mund ta konsiderojmë si mbështetës të tezës së Immanuel Kantit, se liria është e mundur vetëm përmes arsyes, duke i shndërruar në sinonime lirinë dhe ndjenjën e obligimit (gjerm.: Pflicht). Ai, njësoj si Kanti, synon një rend shoqëror të bazuar në liri të individit dhe liri të përgjithshme. Përmes lirisë së Kosovës dhe kombit shqiptar ai sheh realizimin e lirisë së individit dhe lirisë së përgjithshme. Ai synon drejtpeshimin e të dy këtyre segmenteve të lirisë.

Adem Demaçi karakterizohet po ashtu me sensin e tij të barazisë. Ai i konsideron njerëzit të barabartë, pavarësisht përkatësisë kombëtare, gjinore, racore, klasore ose regjionale. Lufta e tij politike në fakt ka për synim barazinë. Barazia e popullit shqiptar me popujt tjerë të Ballkanit është lajtmotivi i tij politik gjatë gjithë jetës së tij. Kjo barazi, sipas tij, jetësohet me bashkimin. Dhe këtë synim do ta mbrojë edhe në kohë të vështira, atëherë kur shpallet herezi të mendosh për të, edhe në kohë bashkëkohore, kur konsiderohet politikisht jokorrekte në kohë trendi të integritimit në BE.

Adem Demaçi është idealist. Ai, përmes veprimtarisë së tij politike, synon realizimin e një gjendjeje ideale në raportet ndërnjerëzore, ndërretnike, ndërshtetërore dhe ndërshoqërore. Ai synon një sistem ku balancohen interesat dhe bëhet shpërndarja e drejtë e të mirave dhe mundësive. Ky është principi bazë i koncepteve të tij mbi drejtësinë.

Drejtësia është një vlerë themelore, princip dhe qëllim etik. Drejtësia duhet t'i pretendojë tri qëllime kryesore: të jetë e paanshme, e dobishme dhe e sigurt. Në luftën për drejtësi Adem Demaçi nuk është konformist. Drejtësinë ai e kupton si një imperativ normativ, që simbolizohet me shprehjen "duhet". Kush dëshiron të jetë i drejtë përballë vetes, ka obligim të jetë i drejtë edhe më të tjerët. Drejtësia nënkuptohet nga ai normë etike veprimi, për të penguar, pamundësuar dhe luftuar të kundërtën e saj, padrejtësinë. Në fjalën e tij në Bruksel Adem Demaçi shprehet me forcë kundër padrejtësisë për shqiptarët duke deklaruar se "e tërë Kosovë është shndërruar në një megaburg, ku shqiptarët nuk gëzojnë as sigurinë më të vogël as fizike as juridike" duke i akuzuar "pushtuesit serbo mëdhenj hegjemonist e militarist, se përmes dhunës më të egër po i presin arteriet jetëdhënëse të popullit shqiptar, duke rrënuar pa mëshirë e plotësisht sistemin informativ, arsimor, shëndetësor, kulturor, sistemin bankar-financiar, ekonomik, juridik dhe përfundimisht duke rrënuar e shkatërruar tërë sistemin politik".



2. Nga shumë vetë Adem Demaçi nuk është kuptuar kur ai vendosi që të marrë përsipër udhëheqjen e Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut në vitin 1991. Por, ai vendosi t'i kushtojë idealit të të drejtave dhe lirive të njeriut. Në fakt të drejtat e njeriut ai i koncepton si të drejta subjektive, të cilat i takojnë secilit. Principi egalitar i të drejtave të njeriut është lajtmotivi i tij prijës në realizimin e të drejtave themelore universale dhe të patjetërsueshme. Një nga filozofët e shquar të shekullit XX Isajah Berlin ka shkruar se "liria politike nuk është gjë tjetër veçse hapësira brenda së cilës njeriu mund të veprojë pa u penguar nga askush tjetër." Në Greqinë antike nocioni i lirisë kuptohej si një nocion i së drejtës. Qytetari konsiderohej atëbotë i lirë në raport me skllavin dhe barbarin. Derisa J.J. Rousseau mendonte se "njeriu lind i lirë, por gjendet gjithkrah i rrethuar nga prangat," tek Hegeli liria nënkuptohej si "liri e vullnetit, e lidhur me një sferë të veçantë të sistemit të filozofisë, me atë sferë që e kishte parasysh njeriun e 'përgjithshëm' veprues historik."

Të drejtat dhe liritë e njeriut shkeleshin në mënyrën më të vrazhdë në Kosovë në kohën kur Demaçi vendos të marrë përsipër të udhëheqë KMDLNJ. Ai e kupton më mirë se kushdo tjetër, se individit duhet mbrojtur nga shteti i dhunshëm, njësoj siç duhet mbrojtur kombi nga shteti pushtues. Ai synon që Serbinë ta obligojë të respektojë normat ndërkombëtare për mbrojtjen e individit. I vetëdijshëm se të drejtat e njeriut kanë natyrë universale, punon që të drejtat dhe liritë e njeriut t'ju përkasin të gjithë

njerëzve, pavarësisht përkatësisë së tyre etnike, gjinore, religjioze, racore ose regjionale.

Raportet në mes të individit dhe bashkësisë në filozofinë politike të Demaçit kanë një konkordancë natyrore. Ai e afirmoi individin në raport me individët tjerë, e njeh të drejtën e tij njerëzore dhe humane, e njeh të drejtën për të qenë ndryshe dhe unik. Raportet intersubjektive i shikon si pasqyrë të së ndryshmes. Ky lloj perceptimi na shpie te konstatimi se ana humane te unë si individ është refleksion i njohjes së të njëjtës anë të tjetrit pranë meje. Ana humane paraqet një kualitet që ne e zotërojmë dhe duhet ta zhvillojmë. Ne e krijojmë botën e njëri-tjetrit, e plotësojmë dhe ndryshojmë atë. Në gjuhën filozofike do të mund thoshim se unë jam, pasi që edhe ti je - ne jemi, pasi që edhe ju jeni. Unë jam, në këtë rast, është një demonstrim subjektiviteti, një vetëidentifikim dinamik me shkallë të caktuar pavarësie, por edhe me elemente të qarta varësie nga bashkësia. Në këtë nivel relacionesh, mund të respektohet dhe mbrohet dinjiteti i njeriut.

Adem Demaçi është kundërshtar i padrejtësisë. Ai lufton për drejtësi për individin, shoqërinë dhe kombën. Të drejtën e individit e koncepton si të drejtë natyrore, e cila duhet mbrojtur në secilin rast dhe në secilin vend. Të drejtën e kombit për liri dhe bashkim e koncepton si të drejtë natyrore, të pakufizueshme dhe të pakomizueshme nga kombet tjera.

3. Hannah Arendt, një nga klasiket bashkëkohore të shkencës politike, tregon një admirim të veçantë në aftësinë e njeriut për veprim praktik politik. Pikërisht në

em Demaçit



këtë dimension të veprimit shoqëror ajo e sheh dështimin e totalitarizmit. Sipas saj praktikë do të thotë, jo se ne duhet të jemi të përcaktuar nga raportet e jashtme, por nga liria e brendshme. Veprimtaria praktike politike e Adem Demaçit e vërteton katërçipërisht konstatimin e Arendt.

Preteksti i arrestimit të parë të Adem Demaçit në vitin 1958 ishte kundër reagim ndaj potencës së tij intelektuale. I profilizuar si një intelektual i ri e me perspektivë, kundërshtar i shpërnguljeve me dhunë të shqiptarëve në Turqi dhe kundërshtar i rreptë i gjakmarrjes, autor i romanit të parë shqiptar pas Luftës së Dytë Botërore, së pari fokusi i Lidhjes së Komunistëve u orientua në anëtarësimin e tij në parti në verën e vitit 1958. Ai nuk pranon për t'u anëtarësuar në parti, në një kohë kur partia e bënte ligjin dhe policin. Fjala e hapur në publik kundër padrejtësive ishte shkas fillestar i arrestimit të tij më 19. Nëntor 1958.

Akuza për propagandë armiqësore ishte një konstrukcion kundër të drejtës së shprehjes dhe mendimit, kundër lirisë së individit dhe kundër të drejtave legjitime të popullit shqiptar në Jugosllavi. Shpallja e tij armik i popullit, "në emër të popullit", kishte për qëllim arritjen e dy synimeve themelore: diskreditimin e tij para opinionit publik dhe frikësimin e inteligjencës së re që po krijohet në Kosovë. Akuzat e mëpastajme në dy burgosjet e mëvonshme për "kundërrevolucion, kundërshtar i socializmit, i barazisë së popujve të Jugosllavisë, rrezikues i sovranitetit shtetëror etj". Duhet kuptuar si një tentim narracioni të Lidhjes Komuniste për të legjitimuar pushtetin e saj

totalitar, të padrejtë, të pabarabartë dhe mizor dhe frikësuar shqiptarët.

Sot, me rastin e vdekjes së tij, studiuesi i filozofisë politike të Adem Demaçit e ka të vështirë ta rreshtojë saktësisht atë në një sistem të mendimit bashkëkohor. Ideja e bashkimit të kombit shqiptar, që e karakterizon fazën fillestare të veprimit të tij politik në Lëvizjen Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve (LRBSH), kombinohet me angazhimin e tij në përfaqësimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe me një vetëidentifikim me vegjëlinë dhe popullin. Ai nuk sillet si përfaqësues i elitës, që merr distancë klasore nga të tjerët. Sjellja e tij politike është punë për të bashkuar njerëzit në luftën për liri. Takon secilin dhe e dëgjon secilin. Pra, ai vetvetëshëm shndërrohet në tribun popullor, në përfaqësues të veprimtarit që synon lirinë, mbrojtës i qytetarit, që i shkelen të drejtat dhe liritë, bashkëpunëtor i luftëtarit, që mbron vijën e frontit dhe qytetarit të lirë, që synon barazinë.

Adem Demaçi ishte njëkohësisht revolucionar dhe luftëtar me moral të lartë patriotik. Mendimi i tij politik ishte humanizëm dhe heroizëm njëkohësisht. Idetë e tij janë aq demokratike, sa edhe revolucionare. Ai shndërrohet në një ikonë të luftës për liri, paqe, drejtësi dhe mbrojtës i të drejtave të njeriut. Ai vendos që problemet e popullit shqiptar në Kosovë t'i personalizojë në ndjenjat e tij dhe veprimet e tij politike. Sistemi i mendimit të tij politik karakterizohet nga vlera dhe ideale të larta, për të cilat vendos të luftojë dhe, në rast nevojë, edhe të vdesë. Gatishmëria e tij sublime për vetësakrificë është e pazakon-

shme, e papërsëritshme, heroike. Çlirimi nacional për Adem Demaçin ishte synimi themelor politik. Por, Adem Demaçi nuk është nacionalist tipik. Mendimi i tij politik është përtej ngurtësisë nacionaliste. Në një intervistë dhënë gazetarit të New York Times më 10 gusht 1999 Adem Demaçi e thërret popullin serb, "i cili gjendet tani në konfuzion, të lirohet prej miteve dhe iluzioneve". Ai fton për pajtim në mes të serbëve dhe shqiptarëve. Duke konstatuar se shqiptarët pas 2000 vitesh skllavërie nga Romakët, Turqit dhe Serbët "tani po marrin frymë lirisht dhe janë në gjendje të vendosin vetë për veten e tyre", ai e konsideron këtë frymë lirie për shqiptarët edhe si një mundësi për serbët.

Demaçi besoi në paqe. Për një kohë të gjatë ai ishte angazhuar për të realizuar qëllimet e tij politike në rrugë paqësore, pa dhunë. Që nga viti 1958, kur u arrestua për herë të parë, ai u mundua ta bind regjimin jugosllav dhe serb, që të rimendojë se mbajtja nën pushtim e Kosovës i kushton vetë regjimit dhe popullit të tij. Ai do të pletojë vazhdimisht të shqiptarët, që t'i konsiderojnë me shumë kujdes pakicat. Ai do t'i ftojë pakicat të integrohen në kuadër të sistemit të Kosovës dhe të kontribuojnë për rindërtimin dhe zhvillimin e vendit.

Por, Adem Demaçi nuk ishte pacifist. Ai ka mbrojtur vazhdimisht konceptin se përdorimi i dhunës në luftën politike mund të vihet në zbatim vetëm atëherë, kur nuk ka rrugë tjetër, kur janë shterur të gjitha mundësitë. Ai ishte i bindur se vetëm me sakrificë, aksione militante dhe veprim të fortë mund të arrihet deri te liria. Ai është mbështetës i tezës së Klauseviçit se "lufta është vazhdim i politikës me mjete tjera." Kur u bë fare e qartë, se regjimi i Millosheviçit nuk i kupton format joviolente të veprimit politik, ai nuk hezitoi të marrë rol drejtues politik në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës.

Mbështetja e luftës së UÇK është rrjedhim logjik i filozofisë politike të Demaçit. Vetë përfaqësuesit ndërkombëtar, që fillimisht nuk e kanë kuptuar qëndrimin e fortë të Demaçit në mbështetje të rezistencës së armatosur, do të detyroheshin të përdornin armët kundër regjimit të Millosheviçit. Të luftosh kundër një shteti policor, pushtues, dhe vrasës të popujve është vlerë politike. Formulimi i ministrit të jashtëm gjerman Joschka Fischer, në vitin 1999, në debatet e ashpra me partinë e tij, në mbështetje të sulmeve të NATO-s kundër Serbisë është nga më precizët në këtë rast: "Unë i mbroj dy principe themelore: kurrë më luftë, por edhe kurrë më Ausshvic, kurrë më vrasje të popujve, kurrë më fashizëm".

4.

Adem Demaçi ishte i ndikuar nga vlerat tona tradicionale kulturore shqiptare. Siç do ta theksojë shumë herë, ai fillimisht do të ndikohet nga nëna e tij, e cila e fton që në mes të nënës Nazife dhe

nënës Shqipëri, të zgjedh këtë të dytën: "Nëna Nazife vdes një ditë, kurse nëna Shqipëri jeton nëpër shekuj!". Në këtë logjikë filozofike popullore mund të konstatojmë identifikimin spontan me vlerën universale të kombit të një gruaje të rëndomtë shqiptare. Kjo logjikë identitare ka qenë shumë e ndrydhur, në kohën kur ai e merr këtë mesazh simbolik, pothuajse profetik, nga nëna e tij.

Adem Demaçin do ta ndikojë edhe mësuesja Vezire. Mësimet e saja për të dashur atdheun dhe kombin, praktika për të filluar mësimet me vjershën që glorifikon "Shqipërinë Nënë" nguliten thellë në ndërdijen e tij. Një filozofi e tillë dashurie për kombin dhe Nënë Shqipërinë nuk është instrumentale, por një ndjenjë e fuqishme për vendin dhe kombin.

Ambienti shoqëror i pas Luftës së Dytë Botërore e influencon Demaçin për ta shndërruar në një filozof popullor e veprimtar politik, por edhe në një orator të rrallë. I pajisur me një nivel të lartë oratorie, me një kombinim të gjuhës dhe filozofisë popullore, ai dëgjohej me vëmendje edhe atëherë kur nuk kuptohet ose keqkuptohet.

Adem Demaçi kishte një pikëpamje të qartë në raportet në mes të politikës dhe moralit. Ai e kupton moralin si tërësinë e parimeve, normave dhe rregullave, që përcaktojnë sjelljen e njerëzve në shoqëri, kurse etikën si disiplinë të filozofisë, e cila në mënyrë metodike dhe sistematike studion veprimin moral. Pra, konceptet etike të Demaçit ishin në konkordancë me konceptin antropologjik të teorisë politike të Aristotelit, i cili e ndërton teorinë e tij mbi polisën (shtetin) dhe kushtetutën e tij mbi bazën e bashkësisë së qytetarëve, duke e definuar njeriun si zoon politikon (qenie politike). Demaçi e preferon si zgjidhje të drejtë të raportit në mes të moralit dhe politikës një balancë të qëndrueshme mes tyre: as zbatim ekskluziv të moralit dhe nënçmim i politikës, por as zbatim ekscesiv i politikës dhe lënie anash e së moralshmes.

Vlera themelore etike e Adem Demaçit ishte vetëmohimi. Ai sakrifikon veten e vet, perspektivën e tij prej shkrimtari dhe intelektualit, për liri dhe bashkim. Ai e lë vetëm nënën Nazife, për hir të Nënës Shqipëri. Ai e sakrifikon mundësinë për të marrë pushtet, për hir të të drejtave të njeriut. Ai e sakrifikon veten e vet, duke mos ikur nga Kosova gjatë luftës, për të demonstruar prezencën shqiptare në Kosovë në kohë lufte. Me këto ai arrin shkallën më të lartë të altruizmit.

Etika politike e Demaçit ishte e orientuar kundër diskriminimit dhe shkeljes së dinjitetit të shqiptarëve nga shteti jugosllav e ai serb. Ai ngritët hapur kundër dominimit të pakicës serbe mbi shumicën shqiptare, duke ja dedikuar qenien e tij luftës për të drejta të shqiptarëve. Më vonë ai kujdeset në mbrojtje të pakicave. Ai ishte në gjendje të falë, duke demonstruar shkallë të lartë tolerance, ndaj atyre që e kanë mbajtur dhe diskriminuar në burg.

Prof. Qosja duke analizuar jetën krijuese, etike dhe politike të Adem Demaçit me të drejtë ka konstatuar: "Jetëshkrimi i tij ka domethënie të pashtershme morale. Për ne kjo është jetë - porosi prej së cilës inteligjencia shqiptare ka mundur dhe do të mund të nxjerrë mësim për mospajtim me të këqijat shoqërore, politike dhe morale kudo dhe kurdo".

Ka pasur plotësisht të drejtë edhe Ukshin Hoti në konstatimin e tij se "një makineri e tërë ishte përpjekur, gati me sukses të plotë, ta heshte jo vetëm kuptimin dhe qëllimin e qëndrimit të tij nëpër burgje, por edhe vet atë, ekzistencën e tij. Për këtë shkak figura e tij e rëndomtë në mënyrë gati të padiskutueshme kaloi në legjendë". Do të kishte qenë normale, që një njeri, me një përjetim të tillë padrejtësie të lartë prej 28 vitesh, të sillej si viktimë. Adem Demaçi nuk e bënte këtë gjë. Ai dëshironte të mos sillet dhe të mos kuptohet nga të tjerët as si hero. I kundërshtonte hapur lajkat dhe lajkatarët në raport me të. I lirë nga çdo kompleks, i hapur për vlerësime politike, vetkritik dhe kritik i rreptë, ai nuk dëshironte ta luajë rolin e heroit. Pikërisht kjo sjellje ia shtonte edhe më shumë madhështinë prej heroit, deshi apo nuk deshi ai, e pranoi apo nuk e pranoi ai. Ai është hero i lirisë, i ndërgjegjes, i drejtësisë, i pavarësisë, i kombit. Ai është hero i pavdekshëm!

5.

Adem Demaçi, që nga dalja në skenën publike si autor e deri në ditën e shkuarjes në amshim, mbeti një nga personalitetet më të shquara të kombit tonë. Edhe atëherë kur emri i tij ishte i ndaluar, kur ai mbahej në burg dhe veprat dhe mendimi i tij ishin shpallur të ndaluara, ai ka qenë dhe ka mbetur personalitet i admirueshëm, i respektuar dhe i dashur. Ai konsiderohet sot, në ditën e shkuarjes në amshim, shqiptari më i shquar në botën shqiptare. Ideat e tij politike, vlerat e tij etike dhe filozofia e tij konsiderohen udhërrëfyes nga një shumicë absolute e shqiptarëve.

Ai ka për të mbetur një njeri i shquar, me tipare të jashtëzakonshme, përkundër vuajtjeve të shumta dhe vështirësive që ka pasur.


Adem Demaçi nuk ka qenë i veshur me pushtet, me asnjë post ekzekutiv dhe legjislativ në Kosovë. Politika dhe shoqëria e Kosovës shpesh nuk e kanë kuptuar, nuk e kanë nderuar dhe nuk i kanë dhënë vendin e merituar sa ishte gjallë. Fakti se ai shpesh ka menduar para të tjerëve, ka paralajmëruar për rreziqet e mundshme për vendin dhe nuk është treguar konformist në raport me të huajt, është bërë, jo rrallë, objekt i sulmeve të padrejta dhe të pandershme, sidomos nga një dorë njerëzish, që karrrierën politike e vënë para interesave të vendit. Megjithatë, tek populli shqiptar Adem Demaçi ka qenë, është dhe do të mbetet përherë lideri shpirtëror i Kosovës së lirë dhe të pavarur. Sa herë flitet për sakrificën e popullit të Kosovës për liri, ai është simboli i saj, simboli i lirisë së Kosovës.

Një 'etimologji' për vetveten (3)

Prof. dr. Hysen MATOSHI

Sipas autores, edhe nataliteti i shqiptarëve ishte pjesë e këtij programi për t'i zënë "shtëpitë e serbëve". Në kundërshtim me logjikën e zhvillimeve historike në Ballkan, e cila qartazi dëshmon se shqiptarët kanë përjetuar restriksion territorial dhe assesi ekspansion. Dëshmi për këtë janë kolonizimet e mëdha, nëpërmjet të cilave u synua ndryshimi i strukturës demografike të Ballkanit në dëm të shqiptarëve. Kësaj duhet shtuar edhe ndërmarrjet masive të pushtetit serb për t'i dëbuar shqiptarët jashtë hapësirës së tyre etnike, veçmas në drejtim të Anadollit. Megjithatë, autorja nuk sheh kurrfarë largimi të shqiptarëve nga Kosova. Përkundrazi, ajo sheh diçka tjetër: dyndjen e shqiptarëve në Kosovë dhe dëbimin e serbëve prej aty. Madje për këtë i fajëson autoritetet jugosllave: "Të gjitha republikat për zhvillimin e Kosmetit kanë ndarë nga 1 për qind të bruto prodhimit kombëtar. Dhe ky popull është zhvilluar, por jo në atë përmasë sa është zhvilluar nataliteti i popullit shqiptar. Kosmeti u bë oazë për shqiptarët e anës tjetër të kufirit të cilët u vendosën në shtëpitë serbe. Në një kaos të këtyllë zhvillohej jeta në Kosmet gjatë gjysmëshekullit të fundit. Qeverisë serbe i ishin lidhur duart. Kosmeti u la në duart e serbëve të varfër, të cilët nuk dëshironin t'i shisnin shtëpitë e tyre dhe thërrisnin për ndihmë, e cila megjithatë nuk u vinte, ndërsa populli shqiptar ndihej i privilegjuar sepse e financonte Jugosllavia nëpërmjet atij njëpërqindëshi të bruto prodhimit kombëtar".

Kosova ishte pjesa më e pazhvilluar në Jugosllavinë Federative. Popullsia e saj, shqiptarët, ishin të lënë pas dore dhe pjesëmarrja e tyre më e madhe shënohej vetëm në dhunën dhe represionin me të cilin përballëshin shqiptarët, si në planin social, ashtu edhe në atë nacional. Dhjetëra mija shqiptarë të ekzekutuar në përfundimin e Luftës së Dytë Botërore, pra në kohën kur kudo po merrnin fund vuajtjet e kombeve shqiptarë u ndodhën para një mësymjeje shfarosëse, e cila vijoi me dëbimin e qindra mija shqiptarëve të tjerë për në Turqi. Këto janë fakte të njohura dhe të dhimbshme. Megjithatë, autorja e librit, në vend se për një komb të rrezikuar nga shfarosja, flet për krijimin e një "populli të rrezikshëm", i cili ende vijonte të zbatonte platformën e Shqipërisë së madhe të bazuar në idetë e Sami Frashërit: "Në socializëm hymë me ide të reja lidhur me barazinë ndërmjet kombeve dhe popujve. Shqiptarët vetëm me fjalë ishin për këto ide, ndërsa në praktikë e zbatonin idetë e Sami Frashërit dhe vendimet e Lidhjes së Prizrenit sipas të cilave është realizuar ideja e Shqipërisë së madhe. Pa asnjë kompromis. Për dekada, populli, i cili ishte pak i zhvilluar në aspektin ekonomik, u shndërrua në armik të rrezikshëm, i cili i dikton rregullat e



lojës."

Testamenti i Sami Frashërit, sipas autores, është projekt për pushtimin e krejt Ballkanit dhe për këtë qëllim shqiptarët u ndihmuakan gjerësisht edhe nga fuqitë e mëdha. Rambujeja u organizua me qëllim që ta vërë në jetë Testamentin e Sami Frashërit! Ajo parashikon që në vijim do të cenohen, përveç Serbisë, edhe Maqedonia, Mali i Zi dhe Greqia: "Fjala arsye nuk ekziston, diskutime këtu nuk ka. Kjo u pa edhe në Rambuje dhe më vonë edhe pas bombardimeve të NATO-s mbi Serbinë. Testamenti i Sami Frashërit, me ndihmën e fuqive të mëdha, nisi të realizohej. Duke pasur aleatë aq të fuqishëm bëhet e qartë se pse serbët e kanë humbur krahinën e tyre. Pushtimi i Ballkanit nga shqiptarët do të vijojë edhe më tej, sepse plani është punuar mjaft mirë dhe nuk është çudi që territori vijues që do të pushtohet të jetë Maqedonia, Mali i Zi dhe Greqia". Jela Nilovic - Mitrovic synon t'i bjerë kambanës së rrezikut shqiptar që do të shtrihet përtej përmasave ballkanike. Pa dyshim, krijimi i një klime albanofobe është qëllimi themelor i saj. Edhe skenaristët e filmave fantastiko-shkencorë do t'ia kishin lakmi kësaj fantazie që

shkon madje deri në kufijtë e Indisë! "Të vetëquajturit dhe të vetëshpallurit pasardhës të ilirëve dhe të Aleksandrit të Maqedonisë i kanë vënë vetes qëllime afatgjata, ndërsa është e njohur se Aleksandri i Maqedonisë kishte shkuar fort larg, ndaj edhe "pasardhësit" e tij do të arrijnë deri në Indi".

Në vend të përfundimit

Pa pretenduar që të sjellim të gjithë "margaritarët" e këtij libri duhet të pranojmë se ai është shkruar me një synim të qartë: të dëshmojë autoktoninë dhe vijimësinë etnike serbe në Ballkan, njëkohshëm duke dëshmuar se shqiptarët janë të ardhur në Ballkan, pavarësisht se nuk ka argumente shkencore të qëndrueshme për këtë gjë. Tezës për "popullin e Zotit" (Bo-ji narod, nebeski narod) ajo i ka kontribuar, duke e avancuar edhe më tej me shpikjen për njëfarë "territori të Zotit", të cilin Zoti vetë ua kishte falur vetëm serbëve dhe u kishte premtuar se do t'ua kthente atë prore (edhe nëse do ta humbnin) pavarësisht zhvillimeve në sferën njerëzore. Prandaj, sipas logjikës së autores, teza për qenësinë serbe të Ballkanit që nga filltet e

njerëzimit nuk duhet të gjurmohet fare, as të argumentohet dhe aq më pak të vihet në sprovë me kundërshtime; thjesht ajo, sipas saj, duhet të besohet si e tillë! Krejt kjo do të ishte në rregull nëse këto teza misionare të saja nuk do të përzi-heshin edhe me nga pak "etimologji". Origjina ilire (ndonjëherë edhe trakase!) e sllavëve, përkatësisht serbëve, është në funksion të dëshimit të kësaj teze. E vetëdijshme për tezën mbizotëruese në shkencën e sotme historiografike, lidhur me origjinën ilire të shqiptarëve, ajo qartazi përpiqet që ta kontestojë, ngase këtë origjinë e "ka rezervuar" për kombin e saj. Ndaj paraprakisht ka bërë përpjekje të mëdha që ta zbulojë një origjinë tjetër për shqiptarët ("Nuk ka logjikë që serbët të kenë dy origjina e shqiptarët asnjë" - mendon ajo), të cilët, sipas saj, mund të jenë edhe kushërinj të suedezëve dhe çka jo tjetër, veçse assesi ilirë dhe as ballkanas madje. Duke shkuar më tej, në këtë kontekst argumentimesh, iu sugjeron shqiptarëve që Kosovën e tyre ta kërkojnë në Skandinavi dhe në Gjermaninë Veriore! Aleati më i madh i saj në këtë ndërmarrje del të jetë etimologjia, një etimologji krejt personale - e saja, me ligjësi linguistike krejt të veçanta dhe të panjohura deri tani, e cila ia bën të mundur që të dëshmojë origjinën skandinave të shqiptarëve. Ajo (etimologjia patriotike personale) ia ofron të gjitha përgjigjet për të argumentuar "të vërtetën" e hedhur kuturu në këto qindra faqe tekst. Sot për sot nuk mund të gjenden shumë dijetarë (madje besoj se nuk ka shumë të tillë as në mesin e vetë serbëve) që do t'i merrnin me seriozitet këto konstatime, por nuk duhet harruar se autorja e librit "Tajna srpskog jezika kod Hiperborejaca - etimološke beleške srpskog jezika i vranjskog govora racene pomocu "Švedskog jezickog ključa", Jela Nilovic - Mitrovic, me këtë vepër, megjithatë, është brenda konceptit "të patriotizmit shkencor". Ajo, sado naive në interpretime dhe argumentime, mbetet fuqishëm në linjën programore të "babait të kombit serb", Dobrica Qosiqit, i cili, lidhur me rrenën, konstatonte: "Rrena është virtyti më i mirë i kombit serb. Ne serbët rrejme me qëllim që ta mashtrujmë veten; rrejme nga turpi, rrejme që t'i ngushëllojmë të tjerët, rrejme që të mos kemi frikë, që të trimërohemi dhe që ta fshehim mjerimin tonë... rrena është një formë e patriotizmit tonë dhe dëshmi e inteligjencës sonë... rrejme në mënyrë kreative, imagjative, inventive"; "rrena është interes shtetëror serb"; "rrena është në vetë qenien e serbit"; "në këtë vend secila rrenë në fund bëhet e vërtetë"; "serbët disa herë gjatë historisë i ka shpëtuar rrena", ose thënia tjetër e tij po për rrenën, e cila, pse të mos thuhet, ngjan në një testament: "Rreni, rreni dhe vetëm rreni, sepse gjithsesi diçka do të mbetet prej saj". Edhe nëse në të gjitha këto thënie, ka pasur ndonjë dozë ironie kontekstuale të "babait të kombit serb", me sa duket, Jela Nilovic - Mitrovic, gjatë punës së saj "shkencore", pikëpamjet e këtylla i ka kuptuar së tepërmi ad litteram.

(Fund)

Amber Rose tregon se me kë Jay Z e tradhtoi Beyoncen



Amber Rose derisa ka folur për jetën personale ka zbuluar edhe identitetin e gruas me të cilën beson se Jay Z e tradhtoi Beyoncen. Sipas Roses, ajo është aktorja fituese e çmimit Oscar, Gwyneth Paltrow. "Definitivisht besoj se Gwyneth Paltrow është gruaja që

ishite me Jay Z, apo jo? Ata ishin shokë më parë, ndërsa tani nuk i shoh Paltrow dhe Beyonce së bashku, duket se ajo është gruaja me të cilën ishte Jay Z" ka thënë Rose. Ndërsa një përfaqësues i aktores ka thënë për "People" se pretendimet e Roses janë absurde dhe 100 për qind false.

Demi Lovato ishte mes jetës dhe vdekjes



Demi Lovato ishte afër vdekjes ditën e martë nga overdoza me drogë. Sipas burimeve të "TMZ", overdoza që kishte përjetuar këngëtarja ishte serioze. Ajo mund të kishte vdekur po qe se ndihma e shpejtë do të vonohej, madje edhe

për vetëm një minutë. Mjekët kishin administruar ilaçin Narcan, i cili ka kundërefekt për opioidë, në shtëpinë e saj. Këngëtarja aktualisht është duke u rikuperuar në spital dhe pritet të hyjë në një program rehabilitimi pasi të dalë nga spitali.



Cardi B: Kam nënvlerësuar të qenit nënë

Cardi B është tërhequr nga turneu i saj me Bruno Mars, që pritej për në vjeshtë. Këngëtarja ka thënë se ka nënvlerësuar të qenit nënë, duke shtuar se ende nuk është e

gatshme ta lërë foshnjën. Cardi u bë nënë më 10 korrik kur erdhi në jetë vajza e saj me Offset nga Migos. 25-vjeçarja pritej t'i bashkohej Bruno Mars në një turne më 24 korrik në Amerikën Veriore.

Brigitte Nielsen, nënë në moshën 54-vjeçare, nxitë debat

Lajmi që Brigitte Nielsen është bërë nënë në moshën 54-vjeçare ka nxitur debat për rritjen e numrit të nënave në moshë më të shtyrë. Aktorja, e cila solli në jetë vajzën Frida në qershor të këtij viti, u detyrua ta mbrojë

vendimin e vet. Nielsen u martua me Mattia Dessi në vitin 2006 dhe kishte ngrirë vezët në moshën 40-vjeçare. Ndonëse kishte gjasë 4 për qind për të mbetur shtatzënë, ajo tha se tretmanët IFV kishin treguar sukses.



Putini e fton Trumpin në Moskë

MOSKË, 27 KORRIK - Presidenti i Rusisë, Vladimir Putin, bëri të ditur se e ka ftuar në Moskë presidentin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald Trump. Putini tha se ai dhe

Trumpi janë të gatshëm të takohen në samitet e ardhshme. Gjithashtu, presidenti rus tha se bisedat telefonike në mes të Moskës dhe ShBA-së nuk ishin të mjaftueshme. Putini tha se

duhet të takohet me Trumpin për të diskutuar në lidhje me marrëveshjen për armët bërthamore të Iranit dhe konfliktet globale. Putini dhe Trumpi u takuan në Helsinki më

16 korrik 2018, por Trumpi në Shtetet e Bashkuara u përball me kritika të mëdha nga republikanët dhe demokratët, të cilët thanë se ai kishte marrë anën e Rusisë në vend të ShBA-së.



Koreja e Veriut kthen eshtrat e 55 ushtarëve amerikanë

Të 55 arkivolet e mbështjella me flamurin e OKB-së barteshin nga ushtarët në një ceremoni solemne dhe brenda tyre besohet të jenë eshtrat e ushtarëve amerikanë të vrarë në luftën e Koresë dhe që u mbajtën për dekada në Korenë e Veriut. Ky është hapi i parë i Phenianit për mbajtjen e premtimeve të bëra në Singapor

PHENIAN, 27 KORRIK - Koreja e Veriut dorëzoi 55 arkivole me eshtra që mendohet se janë të ushtarëve amerikanë të vrarë në luftën e Koresë. Ky është hapi i parë i Phenianit drejt zbatimit të marrëveshjes së arritur në samitin e rëndësishëm të qershorit në Singapor. Të 55 arkivolet e mbështjella me flamurin e OKB-së barteshin nga ushtarët në një ceremoni solemne. Brenda tyre besohet të jenë eshtrat e ushtarëve amerikanë, të vrarë në luftën e Koresë dhe që u mbajtën për dekada në Korenë e Veriut.

Të premtën eshtrat u transportuan me avion në një bazë amerikane në Korenë e Jugut, hapi i parë i Phenianit në mbajtjen e premtimeve të bëra në Singapor. Presidenti amerikan Donald

Trump përmes një komenti në "Twitter" të enjten mbrëma, falënderoi udhëheqësin koreano-verior Kim Jong Un. "Pas shumë vitesh, ky do të jetë një moment i mrekullueshëm për kaq shumë familje", shkruante ai.

Premtimi për kthimin e eshtrave të ushtarëve të vrarë amerikanë u cilësua si një gjest i vullnetit të mirë nga Kim Jong Un në qershor dhe, megjithëse realizimi i tij zgjati më shumë sesa do të dëshironte Uashingtoni, ky gjest rikthen shpresat për përparim në bisedimet bërthamore.

Dorëzimi i eshtrave përkoi me përvjetorin e nënshkrimit të Marrëveshjes së Armëpushimit për Luftën e Koresë. Ndërkaq, të premtën, udhëheqësi i Koresë së Veriut, Kim Jong Un, vizitoi një varrezë të veteranëve



të tij. Armëpushimi, i nënshkruar më 1953, u dha fund luftimeve, por dy Koretë janë teknikiisht në luftë, sepse ato ende nuk kanë nënshkruar një traktat paqesje. Pheniani po bën thirrje për një përfundim zyrtar të luftës si një hap i parë i procesit të paqes. Ata thonë se kjo do të ishte një mënyrë e rëndësishme që Uashingtoni të mund ta garan-

tonte sigurinë e Veriut në këmbim të heqjes dorë nga armët bërthamore.

Dhe duket se po bëhet përparim edhe në këtë drejtim. Sipas imazheve satelitore të kohëve të fundit, Koreja e Veriut tashmë ka filluar të çmontojë një bazë të madhe të lëshimit të raketave.

Në lidhje me kthimin e eshtrave të ushtarëve amerikanë,

një ceremoni zyrtare për nder të riatdhësimin të tyre do të mbahet në bazën amerikane në Korenë e Jugut të mërkurën, më 1 gusht. Ata pastaj do të transportohen me avion në Havai për identifikim të mëtejshëm. Më shumë se 7700 ushtarë amerikanë që morën pjesë në Luftën e Koresë ende figurojnë të zhdukur, 5 300 prej tyre janë zhdukur në Korenë e Veriut.

Tsipras merr përgjegjësinë për zjarret



ATHINË, 27 KORRIK - Pas deklaratës së parë ku u shfaq i tronditur nga tragjedia që po ndodhte në Athinë, ka reaguar sërish për zjarret kryeministri grek Alexis Tsipras, i cili nuk i ka bërë bisht çështjes, por ka theksuar se merr përsipër të gjithë përgjegjësinë politike për "shkrumbimin" e Matit dhe Rafinës. "Të vdekurit nuk mund të flasin, por më së paku u detyrohemi respektimin e së vërtetës. Unë ju thirra sot, sepse unë dua të marr përsipër, para kabinetit dhe popullit,

përgjegjësinë politike për tragjedinë", tha kryeministri. Në mbledhjen e jashtëzakonshme të qeverisë, Tsipras tha se do të diskutohen më vonë edhe largimet ministore për shkak të tragjedisë që i kushtoi jetën 87 njerëzve në Atikën Lindore. Ai theksoi se "nuk jemi këtu për ta përjetësuar pushtetin që populli grek na dha", por për t'i pranuar gabimet dhe për këtë kritikoi ata që janë "përpjekur për ta shfrytëzuar tragjedinë vdekjeprurëse".

Tsipras theksoi se ky është momenti më i rëndë në karrierë për shumë ministra dhe tha se të gjithë kanë anktë e pyesin veten nëse mund të kishin bërë më shumë për të shpëtuar jetë. "Pyesim nëse bëmë gjënë e duhur në këtë situatë. Nëse do t'i përgjigjeshim më kohë situatës kritike, nëse mund të bënim më shumë duke shpëtuar qoftë edhe një shpirt nga ata që u larguan. Unë nuk shmangem nga mendimi apo nga frika", tha Tsiprasi.

Imran Khan, fitues i zgjedhjeve në Pakistan

ISLAMABAD, 27 KORRIK - Komisioni i Zgjedhjeve në Pakistan tha të premtën se ish-sportisti i famshëm i kthyer në politikan, Imran Khan, ka fituar zgjedhjet parlamentare, por partia e tij nuk arriti të fitonte vota të

mjaftueshme për një shumicë të qartë dhe do t'i duhet të formojë një qeveri koalicioni. Khani e shpalli fitoren e partisë së tij Tehreek-e-Insaf të enjten. Në një fjalim për fitoren, ai u zotua ta luftonte varfërinë dhe

korrupsionin e përhapur përmes reformimit të sistemit qeverisës në vend. Partia e tij kishte një avantazh të thellë ndaj partisë rivale Lidhja Myslimane e Pakistanit e ish-kryeministrit të burgosur,

Nawaz Sharif. Pothuajse të gjitha partitë kryesore rivale kanë akuzuar për manipulime në votim në favor të Khanit, por Komisioni i Zgjedhjeve i Pakistanit i ka hedhur poshtë këto akuzë.



E jashtëzakonshme

I moshuari kishte ngecur poshtë kamionit, por shpëton

Disa burra janë bashkuar për ta shpëtuar jetën e një të moshuari që kishte mbetur poshtë një kamioni. Ngjarja ka ndodhur në Londrën lindore. Ai po bërtiste kur shoferi donte ta lëvizte automjetin dhe punëtorët aty rrotull, së bashku me këmbësorët, u



bashkuan për ta ngritur kamionin dhe e shpëtuan të moshuarin.

FOTO E DITES



Një burrë i moshuar pakistanez tregon gishtin e tij pas hedhjes së votës në zgjedhjet e përgjithshme në Lahore. /AFP/

E rrallë

Braktiset foshnja e porsalindur në tualetin e avionit

Një foshnjë e porsalindur, që dyshohet të ketë lindur pa shenja jete, është gjetur e braktisur brenda një tualeti në avionin 'AirAsia' që bëri zbritje në Nju Delhi. Nëna e foshnjës, e cila besohet të jetë nën moshë, dyshohet të ketë lindur në avion. Ajo po mbahet nga policia për t'u marrë në pyetje. Sipas medieve lokale, foshnja u gjet me letër



tualeti në gojë, por ende nuk dihet saktësisht si ndodhi lindja.

BARSOLETA E DITËS



I thotë biondja shoqes së vet:

- Paramendo, dje u ndal rryma, mbeta në ashensor një orë rrafsh!
- Po kjo nuk është asgjë. Unë kam mbetur tri orë në shkallët lëvizëse.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjate vikendit në ora 16:00

“INCREDIBLES 2” 3D

I Animuar/Aksion/Aventure; 1 ore 58 min

Rolet: Holly Hunter, Craig T. Nelson, Sarah Vowell, Huck Milner, Samuel L. Jackson, etj.

Regjia: Brad Bird




Në ora 18:20

“FUTURE WORLD”

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

Rolet: James Franco, Suki Waterhouse, Milla Jovovich, Lucy Liu, Jeffrey Wahlberg, Snoop Dog, etj.

Regjia: James Franco



Në ora 20:00

“ANT-MAN AND THE WASP” 3D

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 1 orë 58 min

Rolet: Paul Rudd, Evangeline Lilly, Michael Pena, Michael Douglas, Michelle Pfeiffer, Laurence Fishburne, etj.

Regjia: Peyton Reed



Në ora 22:00

“LOVING PABLO” (R)

Biografi/Krim/Drame; 2 ore 03 m

Rolet: Javier Bardem, Penélope Cruz, Peter Sarsgaard, etj.

Regjia: Fernando León de Aranoa



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, [fb: Kino ABC](https://www.facebook.com/kinoabc).




DASHI

Në të shkuarën tuaj keni realizuar atë që keni dashur. Filloni të keni të njëjtin shpirt iniciative edhe sot.



DEMI

Jeni të preokupuar shumë me çështjet e punës dhe nuk po u kushtoni rëndësi vlerave afektive në jetën tuaj.



BINJAKËT

Edhe pse mënyra juaj e komunikimit nuk do të pëlqehet nga të gjithë, vazhdoni të jeni korrekt dhe të sqartë në ato që thoni.



GAFORRJA

Të jepni ultimatum sot mund të mos jetë zgjidhja më e mirë për ta vendosur autoritetin tuaj.



LUANI

Në të ardhmen partneri do t'ju fajësojë për një vendim që nuk e morët në kohën e duhur.



VI RGJËR ESHA

Nuk është e nevojshme që të tjerët t'ju tregojnë rrugën sot. Jeni në gjendje të vendosni vetë edhe duke qenë nën presion.



PESHORJA

Sot do të keni disa pasoja në punë që do të përcillen edhe në shoqëri. Mbase duhet të pranoni që edhe ju gaboni.



AKREPI

Mos mendoni sot se si të hakmerreni ndaj një rivali tuaj. Lërjani çdo gjë në dorë kohës sepse hakmarrja është një pjatë që shërbehet e ftohtë.



SHIGJETARI

Sot do të vendoseni përballë situatave të ndryshme që duhet t'i jepni zgjidhje të shpejtë. Do të tregoheni mjaft fleksibel.



BRICJAPI

Po vini në vështirësi këdo që ju qëndron pranë dhe do të vijë një moment që durimi do të soset. Kujdes me sjelljet sot.



UJORI

Provoni t'i ngjisni një nga një shkallët e suksesit. Mos tentoni të keni të gjithë tortën sot.



PESHQIT

Duhet të filloni të merrni vendime që duhet të pranohen nga të gjithë. Sot është një ditë që do t'ju tregojë se jeni lider në fushën tuaj.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

STURM GRAZ - HARTBERG

1

LOKOMOTIVA - INTER ZAPRESIC

1

OSTERSUNDS - ELFSBORG


GG3+

Haradinaj: Basketbollistët do ta kenë përkrahjen institucionale në garat ndërkombëtare

PRISHTINË, 27 KORRIK - "Anëtarësimi në FIBA i Federatës së Basketbollit të Kosovës u ka mundësuar të rinjve tanë të marrin pjesë në shumë se 18 gara ndërkombëtare duke shënuar rezultate të mira dhe tani të bëhen edhe nikoqir i një organizimi ndërkombëtar. Ky është sukses i madh për Kosovën dhe është arritur falë talentit dhe përkushtimit të basketbollistëve", ka thënë kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, pasi ka pritur në takim një delegacion të Federatës Ndërkombëtare të Basketbollit (FIBA), të kryesuar nga drejtori ekzekutiv, Kamil Novak dhe Arben Fetahu, kryetar i Federatës së Basketbollit të Kosovës. Haradinaj me këtë rast ka njoftuar Novakun për

përkushtimin dhe investimet e Qeverisë së Kosovës për përmirësimin e infrastrukturës sportive në Kosovë, në mënyrë që të rinjtë dhe sportistët ta kenë mundësinë e ushtrimit të aktiviteteve të tyre sportive. "Ne kemi arritur që pas 19 vjetësh prolongim e humbje, Pallatin e Rinisë t'ia kthejmë Prishtinës, qytetarit të saj, sportistëve dhe artistëve. Sportistët tanë, veçmas basketbollistët, tani e kanë në dispozicion këtë hapësirë, e cila, falë statutit të ri të zgjidhur, do të mund të marrë investime të nevojshme, që të krijojë kushte edhe më të mira për zhvillimin e sportit", ka shtuar Haradinaj.

Ai ka falënderuar përfaqësuesit e FIBA-s dhe të Federatës së Basketbollit të Kosovës për organizimin e Kampionatit Evropian



FIBA U18 në Kosovë, duke thënë se ngjarjet sportive si këto janë të rëndësishme jo vetëm për basketbollin, por për sportin në përgjithësi. Anëtarësimi i Kosovës në FIBA, sipas kryeministrit Haradinaj, u ka krijuar

mundësi basketbollistëve tanë që të garojnë dhe të jenë pjesë e drejtpërdrejtë në konkurrencën e grupmoshave të ndryshme. Ndërkaq, drejtori ekzekutiv i FIBA-s, Kamil Novak, tha se qëllimi i vizitës është për ta parë

nga afër organizimin e FIBA-s U18 Kampionatit Evropian, Divizioni C, që është duke u zhvilluar në Prishtinë dhe për ta konfirmuar mbështetjen e FIBA-s për Federatën e Basketbollit të Kosovës.

Shtyhet ndeshja testuese për shkak të vdekjes së Adem Demaçit

PRISHTINË, 27 KORRIK - Federata e Futbollit e Kosovës (FFK) ka vendosur për shtyrjen e ndeshjes testuese në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë. Shkak i kësaj shtyrje është vdekja e atdhetarit të çështjes kombëtare, Adem Demaçi. "Për shkak të vdekjes së atdhetarit, simbolit të rezistencës, Adem Demaçi, siç quhet ndryshe edhe Mandela i Kosovës, dhe për faktin se presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, në nderim të tij ka shpallur tre ditë zie, Federata e Futbollit e Kosovës njofton opinionin se ndeshja testuese që ishte paraparë të zhvillohej nesër, më 28 korrik, në stadiumin 'Fadil Vokrri', është pezulluar për një kohë tjetër dhe në koordinim të plotë me UEFA-n dhe inspektorët e saj. Për terminin e ri opinionin do të njoftohet me kohë në ditët në vijim", thuhet në njoftimin e



FFK-së.

Në ndeshjen testuese do të përballen veteranët e KF Flamurtarit nga Vlora, veteranët e FC Prishtina dhe një ekip i përbërë nga politika dhe estrada, kurse zhvillimi i kësaj ndeshje po pritet me interesim të jashtëzakon-

shëm, pasi tash e tutje ky stadium do ta bartë emrin e legjendës së futbollit dhe ish-kryetarit të Federatës së Futbollit të Kosovës, Fadil Vokrri, por edhe për faktin se në këtë ndeshje të pranishëm do të jenë inspektorët e FIFA-s për inspektim.

Gjysmëfinalet: Irlanda - Kosova dhe Qipro - Monako

PRISHTINË, 27 KORRIK - Kosova U18 e ka siguruar një vend në gjysmëfinale të FIBA U18 Kampionatit Evropian, Divizioni C, që është duke u zhvilluar në Prishtinë. Kosova në luftë për një vend në gjysmëfinale e ka mposhtur Gjibraltarin me rezultat 77:47 në ndeshjen e luajtur të enjten mbrëma. Në fazën e grupeve Kosova e ka shënuar një fitore bindëse ndaj San Marinos

dhe një humbje nga Qiproja në sekondat e fundit të ndeshjes. Në gjysmëfinalet që do të zhvillohen të shtunën, Kosova me fillim nga ora 17:00 do të ballafaqohet me Irlandën, e cila në fazën e grupeve nuk e ka regjistruar asnjë humbje, njëjtë si Qiproja në grupin tjetër, e cila tani do të përballet në gjysmëfinale me Monakon. Ky takim do të luhet me fillim nga ora 19:30.



Klubet "Besa" e "Ilirida", fitues të turneut "Esmir Shala" në not

PRISHTINË, 27 KORRIK - Në pishinën e Banjës së Malishevës është mbajtur kupa përkujtimore në not "Esmir Shala", garë kjo tradicionale dhe zyrtare, në bashkëpunim me Komunën e Malishevës, Klubin e Notit "Besa" dhe Federatën e Notit të

Kosovës. Gara ka filluar me mbajtjen e një minute heshtje në nderim të Adem Demaçit, bëhet me dije në një komunikatë për media. Në këtë garë ekipe fituese janë: Klubi i Notit "Besa" për meshkuj, ndërsa për femra Klubi i Notit

"Ilirida".

Në hapjen e garave kanë marrë pjesë edhe zyrtarët e Federatës së Notit, përkatësisht kryetari i federatës Imer Rama, si dhe drejtoresha e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Besartë Kryeziu-Ramaj. Duke folur në

hapjen e garave, drejtoresha Besartë Kryeziu-Ramaj, pasi i ka uruar pjesëmarrësit, ka thënë se "Esmiri të jetë motiv për generatat e reja që merren me sportin e notit dhe ju të jeni të suksesshëm, ashtu siç ishte edhe Esmiri". Në këtë garë kanë marrë pjesë

mbi 150 garues nga 14 klube të notit dhe tri shkollave të notit, ku vendin e parë për meshkuj e zuri "Besa", të dytin "Termopan" dhe të tretin "Ilirida". Ndërsa te femrat, vendin e parë e zuri ekipi "Ilirida", të dytin "Prishtina", vendin e tretë "Zenit".

Isufi: Na mposhtën gjyqtarët

GJILAN, 27 KORRIK - TRAJNERI I Dritës së Gjilanit, Bekim Isufi, është i bindur se skuadra e tij pësoi humbje për shkak të padrejtësive që iu bënë nga gjyqtarët nga Qipro. Drita ishte

në epërsi ndaj F91 Dudelange 0-1 në pjesën e parë, por në fund e humbi ndeshjen 2-1. "Ne dhamë maksimumin në këtë takim, ku patëm shumë raste shënimi, por edhe

kundërshtari pati raste njësoj. Vlen të theksohet se gjatë gjithë takimit kemi qenë pre e një skenari të katër gjyqtarëve nga Qiproja, vendimet e të cilëve ndikuan plotësisht në rezultat

jo vetëm tek dhënia e penalltisë, por gjatë tërë ndeshjes. Po ashtu, duhet theksuar se kundërshtari në shumë raste nuk respektoi 'fair-play'-in ndaj nesh", ka thënë Isufi.



Hysaj: Ronaldo nuk do t'i shënojë Napolit



NAPOLI, 27 KORRIK - Juventusit është përforcuar me Cristiano Ronaldo, por shqiptari i Napolit, Elseid Hysaj, nuk frikësohet aspak. Mbrojtësi kuqezi ka thënë se ylli portugez nuk do t'i shënojë Napolit. "Ronaldo nuk do t'i shënojë Napolit. Siç e dimë të gjithë, ai është lojtar i nivelit shumë

të lartë. Më bëhet qejfi që ka ardhur në Itali. Na stimulon shumë prania e tij. Ruajtja i tij është një sfidë që më pëlqen. Ne jemi një grup i madh dhe një lojtar i vetëm nuk bën gjithçka. Të shohim si do të përshtatet në Itali. Një lojtar i vetëm mund ta bëjë diferencën në një ndeshje të caktuar, por jo përg-

jatë gjithë kampionatit", ka thënë Hysaj, i cili ka folur edhe për trajnerin e ri Carlo Ancelotti. "Duhet ta ndryshoj stilin e lojës me Ancelottin? Nuk është problem, Ancelotti mbetet trajner i madh. E di se çfarë kërkon nga unë. Do të jap gjithmonë më të mirën në fushë", ka deklaruar Hysaj.

Hamiltoni i fokusuar në garën e Hungarisë

LONDËR, 27 KORRIK - Fitorja në Hockenheim të Gjermanisë dhe ngjitja në krye të klasifikimit e gjen britanikun Lewis Hamilton optimist dhe të karikuar edhe në fundjavën e Hungarisë. "Gara e Gjermanisë ka qenë një ndër më të bukurat e karrierës time dhe rëndësia e saj shtohet duke qenë se unë jam në këtë sport prej shumë vitesh dhe e kam të vështirë t'i veçoj episodet. Jam krenar për atë që realizuam fundjavën e shkuar. Tani, objektivi im si pilot, por edhe ai i skuadrës, është të fokusohemi se ku mund të përmirësohemi më shumë", ka deklaruar 33-vjeçari i Mercedesit në pritje të garës së radhës, Çmimit të Madh të Budapestit. Lidhur me vendimin e komisarëve për të mos e penalizuar manovrën e tij të papritur për hyrjen dhe daljen në bokse, Hamiltoni, katër herë kampion bote, shton: "Mendoj se ishte një moment i rëndësishëm, të cilin do ta përsëritja.



Skuadra duhej të merrte një vendim në fraksion të sekondës, diçka aspak e lehtë. Vendimi për të qëndruar në pistë ishte i

duhuri, sepse edhe ndjesia ime kështu foli, isha mirë me kohën dhe rezultoi që veprimi im ishte ai i duhuri".

SHKURT

Avdijaj largohet nga Schalke

Sulmuesi i Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Donis Avdijaj, ka konfirmuar largimin nga Schalke. "Negociatat jemi duke i vazhduar", ka thënë menaxheri i Avdijajt, Karsten Schmidt për "WAZ". Sulmuesi me Schalken ka kontratë deri në verën e vitit 2019. Në Bundesligë ka shënuar dy gola në nëntë paraqitje. Ai është huazuar dy herë nga klubi i Schalkes. Një herë në Sturm Graz, së fundi te Roda në Holandë.

Alonso: Pas verës vendosi për të ardhmen në Formula 1

Fernando Alonso ka deklaruar se do ta zbulojë të ardhmen e tij në Formula 1 pas verës. Kohët e fundit ka pasur zëra se piloti spanjoll mund të kthehet te Ferrari, por vetë ai ka thënë për "AS" se të gjithë flasin, por ai nuk do t'i përgjigjet gjithçkaje që dëgjon. "Më kanë mbetur 10 gara me McLaren. Do ta përfundoj sezonin me makinën që kam, kjo është e sigurt. Për sa i përket vitit të ardhshëm, pasi të kalojë vera do të mësoni më shumë", u shpreh dy herë kampioni i botës në F1. Fernando Alonso renditet në vendin e tetë në klasifikimin e pilotëve, me 40 pikë.

Barça e kërkon portierin e Liverpoolit

Barcelona është duke konsideruar seriozisht një ofertë për portierin e Liverpoolit, Simon Mignolet. Belgu 30-vjeçar ka humbur vendin e titullarit në Anfield dhe aktualisht është portieri i tretë në dispozicion të Jurgen Klopp pas Alissonit dhe Kariusit. Mignolet do të ishte rezerva e Andre ter Stegen te Barcelona. "Marca" pretendon se ai mund të zëvendësojë Jasper Cullessen, i cili pritet të largohet nga gjigantët katalanas për të luajtur si titullar diku tjetër. Besiktas gjithashtu është duke vëzhguar me kujdes situatën e Mignolet, ndërsa Barça mendohet se mund të provojë edhe për portierin e Wolfsburg Koen Casteels.

Pjaniqi: Jam i lumtur te Juventus

E ardhmja e Miralem Pjaniqit në Juventus është duke u diskutuar shumë në ditët e fundit. Manchester City dhe Chelsea janë skuadrat që kanë shfaqur interesim të madh për boshnjakun. Pjaniqi ka dhënë një intervistë të shkurtër për "Sky Sport" gjatë turneut me klubin në ShBA. "Kam lexuar shumë gjëra të cilat më kanë bërë të qeshë, por unë jam i qetë dhe jam duke i bërë përgatitjet e mia. Këtu unë jam shumë i lumtur, pasi jam me një skuadër të mirë dhe kam marrëdhënie të shkëlqyera me trajnerin. Çmimi që është vendosur për mua nga mediet? Kjo do të thotë se jam duke luajtur mirë", ka thënë Pjaniqi.

Grindeli pendohet për Ozilin: Më falni, nuk jam një racist

Presidenti i Federatës Gjermane të Futbollit, Rainhard Grindel, ka pranuar gabimet e trajtimit të çështjes së Mesut Ozilit pas polemikave që shkaktoi fotoja e tij me presidentin turk, Rexhep Taip Erdogan. Mesfushori i dha fund karrierës së tij 9-vjeçare me kombëtaren gjermane javën e shkuar, duke e akuzuar DFB-në se e kishte trajtuar atë me racizëm dhe pa respekt. Ylli i Arsenalit kritikoi federatën, presidentin Grindeli personalisht, tifozët dhe medien për atë që ai e quajti racizëm në trajtimin e njerëzve me prejardhje turke. 29-vjeçari e mbrojti takimin e tij me Erdoganin, i cili është një figurë shumë e kritikuar në Berlin për shkak të autoritarizmit të tij. "Deklarata e dorëheqjes bërë nga Mesut Ozil erdhi për shkak të një debati mbi racizmin në përgjithësi dhe aftësisë së futbollit për të integruar në veçanti. Si president i DFB-së unë nuk dua t'i shpëtoj këtij debati. Në retrospektivë, unë si president duhet të kisha thënë pa dyshim atë që për mua dhe për federatën është e qartë: se çdo formë armiqësie racore është e patolerueshme. Ju kërkoj ndjesë, nuk jam një racist".



Në bazë të Nenit 8 të Ligjit të Punës (Ligji nr. 03/L-212), UA MPMS nr. 07/2017 dhe Rregullores për Rregullimin e Marrëdhënies së punës 01-2456/17, PK Sh.A. shpall:

KONKURS PUBLIK PËR VENDE PUNE

Titulli i pozitës: 1. Punëtor/e Sporteli, grada 5,
2. Postier/e me orar jo të plotë të punës (4 h), grada 3

Nr. References: 01-1620-2/18

Përshkrimi: PK Sh.A. është duke bërë përpjekje për të zhvilluar biznesin sipas përvojave më moderne të shërbimeve postare dhe komerciale, për t'i arritur standardet ndërkombëtare në ofrimin e shërbimeve postare dhe komerciale. Në këtë aspekt, PK Sh.A. ofron mundësi të barabartë punësimi të profesionistëve që synojnë të jenë pjesë e zhvillimit të biznesit dhe kompetencave të Korporatës, në përputhje me metodat dhe praktikat moderne.

Kohëzgjatja e kontratës: Konform nenit 4 dhe 15 të Rregullores për Rregullimin e Marrëdhënies së Punës për Punonjësit e Postës së Kosovës nr. 01-2456/17, të datës 20.09.2017, kontrata e punës është për kohë të pacaktuar, në të cilën periudhë përfshihet edhe periudha provuese 6 muaj.

Aplikimi: Aplikacionet mund të merren online www.postakosoves.com dhe së bashku me dëshmitë përkatëse të dërgohen nëpërmjet postës në adresën: **Arkiva e PK Sh.A., Ndërtesa Kryesore e PK-së, Rr. 28 Nëntori nr. 4, 10000 - Prishtinë**, deri në afatin e paraparë për aplikim me shenjë "PËR KONKURS", duke e cekur titullin e vendit të punës për të cilin aplikoni.

Aplikacioni dhe të gjitha dëshmitë bashkëngjiten të fotokopjuara, sepse të njëjtat nuk iu kthehen aplikantëve.

Aplikacionit patjetër duhet t'i bashkëngjitet apo të silltet më vonë tek RNJ-të e PK SH.A., dëshmia (vërtetimi) se aplikanti/ja nuk është nën hetime dhe i/e dënuar.

Afati i fundit për aplikim: 11/08/2018, ora 16:00.

Vendi i punës:

1. Punëtor/e Sporteli, Punëtor/e Sporteli, 5 ekzekutues (4 ekzekutues në regjionin e Prishtinës dhe 1 ekzekutues në regjionin e Prizrenit)

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

Ofron shërbime dhe shet të gjitha produktet në sportel, përfshirë edhe implementimin e dimensioneve të parapara dhe raportimin. Është përgjegjës/e për ofrimin dhe shitjen e të gjitha produkteve dhe shërbimeve; Mban përgjegjësi për furnizim të rregullt, ngarkesë me pulla, vlera postare dhe produkte për shitje; Është përgjegjës/e për klasifikimin dhe ruajtjen e dokumentacionit manipulativ financiar në baza ditore, dekadore dhe mujore; Është përgjegjës/e për mirësjellje dhe zbatimin e Kodit të Mirësjelljes; Raporton te Kontrollori/ja i/e Ndërrimit ose Përgjegjësi/ja i/e Postës në baza ditore, dekadore dhe mujore; Kryen edhe punë tjera të nevojshme, të parashtruara nga Kontrollori/ja ose Përgjegjësi/ja i/e Postës; Për punën e vet i raporton Kontrollorit të ZP/Përgjegjësit të Zyrës Postare.

Kualifikimi dhe përvoja e nevojshme:

Punonjësi/punonjësja, për ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësi të Punëtorit/es së Sportelit duhet të ketë kualifikim universitar ose kualifikim të mesëm dhe së paku 1 vit përvojë pune në ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësi të ngjashme si në përshkrimin e vendit të punës.

Vendi i punës:

2. Postier/e me orar jo të plotë të punës, 2 ekzekutues (1 ekzekutues në regjionin e Prishtinës dhe 1 ekzekutues në regjionin e Prizrenit)

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

Pranon dhe shpërndan letër-dërgesat, kolipostat, apo produktet tjera që ofron PK Sh.A., të ndara/ngarkuara nga kartuesi/ja; Është përgjegjës/e për pranimin, dorëzimin e letër-dërgesave, kolipostave në rajonin përkatës; Bën shitjen e produkteve sipas shërbimeve që ofrohen nga PK Sh.A. dhe është përgjegjës/e për arritjen e targeteve të caktuara nga qendra për shitjen e produkteve; Mban përgjegjësi për produktet e pranuar për shitje, tel. USSD, evidencë, klasifikim dhe ruajtje të dokumentacionit manipulativ në baza ditore, dekadore dhe mujore; Zbaton ndryshimet e paraqitura në lidhje me shpërndarjen dhe dorëzimin; Është përgjegjës/e për mirësjellje, zbatimin e Kodit të Mirësjelljes dhe Kodit mbi Trajtimin e Dërgesave Postare; Kryen edhe punë tjera të nevojshme të parashtruara nga Kontrollori i Shpërndarjes/Kartuesi apo Përgjegjësi i Zyrës Postare; Për punën e vet i përgjigjet Kontrollorit të Shpërndarjes/Përgjegjësit të Zyrës Postare.

Kualifikimi dhe përvoja e nevojshme:

Punonjësi/punonjësja, për ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësi të Postierit/es duhet të ketë kualifikim të mesëm, preferohet në drejtimin e shërbimit postar.



U skladu sa članom 8. Zakona o radu (Zakon br. 03 / L-212), Administrativno Uputstvo Ministarstva Rada i Socijalne Zaštite br. 07/2017 i Pravilnik o regulisanju radnih odnosa 01-2456/17, PK A.D. objavljuje:

JAVNI KONKURS ZA RADNO MESTO

Naziv radnog mesta: 1. Radnik /ca Šaltera, rang 5
2. Poštar/ka sa nepuno radno vreme (4 sata), rang 3

Referentni Br. 01-1620-2/18

Opis:

PK A.D. nastoji da razvije poslovanje u skladu sa

zapošljavanja za profesionalce koji imaju za cilj da budu deo razvoja poslovanja i nadležnosti korporacije u skladu sa savremenim metodama i praksama.

Trajanje Ugovora: U skladu sa članovima 4 i 15 Pravilnika o regulisanju radnih odnosa za zaposlene u Pošti Kosova Br. 01-2456/17 od 20.09.2017. godine, ugovor o radi je za neodređeno vreme, koji uključuje probni period od 6 meseci.

Aplikacija: Aplikacije možete preuzeti na internetu www.postakosoves.com i zajedno sa relevantnim dokazima poslatim poštom na adresu: **Arhiva PK A.D. "Glavna zgrada PK, Ul. 28. Novembar Br. 4, 10000 – Priština"**, do roka za prijavu obeležen naznakom radnog mesta za koji se prijavljujete.

Aplikacije i svi dokazi priložiti fotokopirane

Aplikacije se moraju priložiti ili kasnije dostaviti LJR PK A.D., dokaz (potvrda) da podnosilac prijave nije pod istragom ili osuđen.

Zadnji rok za prijavu: 11.08.2018, vreme 16:00 časova.

Radno mesto

1. Radnik/ca Šaltera, 5 izvršioca, (4 izvršioc u regionu Pristina i 1 izvršilac u regionu Prizrenu)

Glavne dužnosti i odgovornosti:

Pružna prodajne usluge svih proizvoda na šalteru, uključujući i realizaciju predviđenih dimenzija i izveštavanja; Odgovoran je za pružanje i prodaju svih proizvoda i usluga; Odgovoran je za redovno snabdevanje poštanskih marka, poštanskih vrednosti i proizvode za prodaju; Odgovoran je za klasifikaciju i održavanje finansijskih manipulativnih dokumenata svakodnevno, dekadentno i mesečno; Odgovoran je za učtivost i primenu Kodeksa ponašanja; Izveštava svakodnevno, dekadentno i mesečno Kontroloru smene ili Odgovornog lica pošte. Obavlja i druge neophodne poslove postavljene od Kontrolora, ili Odgovornog lica pošte; Za svoj rad, izveštava Kontroloru / Odgovornom licu pošte.

Obrazovanje, veštine i ostalo:

Zaposlenik/zaposlenica za obavljanje dužnosti i odgovornosti Radnik Šaltera treba imati univerzitetsku kvalifikaciju ili kvalifikaciju srednje škole i radno iskustvo najmanje 1 godinu u vršenju sličnih dužnosti i odgovornosti kao u opisu radnog mesta.

Radno mesto

2. Poštara/ke sa ne-punim radnim vremenom, 2 izvršioca (1 izvršilac u regionu Pristina i 1 izvršilac u regionu Prizrenu)

Glavne dužnosti i odgovornosti:

Primi i isporučuje pismonosne pošiljke, paket ili druge proizvode koje pruža PK A.D. odvojene/zadužene od Kartista; Odgovoran je za prijem, predaju pismonosnih pošiljka, paketa u odgovarajućoj regiji; Prodaje proizvode prema uslugama koje pruža PK A.D. i odgovoran je za postizanje određenih ciljeva iz centra za prodaju proizvoda; Odgovoran za proizvode primljene za prodaju, tel., USSD, evidenciju, klasifikaciju i očuvanje manipulativne dokumentacije svakodnevno, dekadentno i mesečno; Primenjuje promene predstavljene u pogledu dostave i uručjenja; Odgovoran za učtivost, sprovođenje Kodeksa ponašanja i Kodeksa za rukovanje poštanskim pošiljkama; Obavlja i druge neophodne poslove postavljene od Kontrolora Distribucije/Kartista ili Odgovornog lica pošte; Za svoj rad, izveštava Kontroloru Distribucije/Odgovornog lica pošte.



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

NJOFTIM

Të gjithë investitorët potencial që planifikojnë të ofertojnë në

Shitjen 39

të aseteve të ndërmarrjeve në Likuidim, njoftohen se dita e dorëzimit dhe hapja e ofertave është:
e mërkurë **01 gusht 2018**, prej orës **10:00 - 12:00**, në Sallën e Kuqe të Pallatit të Rinisë dhe Sporteve, Prishtinë

Njësia nr.01: Pasuria Bujqësore Toka në Bablak (Lot A)	Njësia nr.41: IMB Lokali 8	Njësia nr.88: Ratar Tokë Bujqësore Graçanicë I
Njësia nr.02: Plantacioni Toka në Kosinë (Lot A)	Njësia nr.42: Agrokultura Depo në Bare	Njësia nr.92: KB Kosova Tokë Bujqësore Ribar i Vogël I
Njësia nr.03: Morava Partesh Toka në Cërnice (Lot A)	Njësia nr.43: Produkti Tokë në Baks	Njësia nr.93: Mekanizimi Lokali nr.1 Mitrovicë e Veriut
Njësia nr.04: Agromorava Toka në Sadovinë e Çerkezve (Lot A)	Njësia nr.44: Produkti Tokë në Brojë 1	Njësia nr.94: Tokë Bujqësore Llapashticë e Poshtme I
Njësia nr.05: Agromorava Toka në Sadovinë e Çerkezve (Lot B)	Njësia nr.45: Produkti Tokë në Brojë 2	Njësia nr.95: Tokë Bujqësore Llapashticë e Epërme
Njësia nr.06: Agromorava Toka në Tërstenik (Lot A)	Njësia nr.46: Elan Parcela 1001-0 Muhaxheri i Epërm/Studime e Epërme	Njësia nr.96: Tokë Bujqësore Llapashticë e Poshtme II
Njësia nr.07: Morava e Binçës Vetura Mercedes	Njësia nr.48: Tokë në Vojnik	Njësia nr.97: Duhani Lokali Afarist Mitrovicë
Njësia nr.08: Kualiteti Lokali në Gjilan	Njësia nr.49: Elan Tokë në Dubovc	Njësia nr.100: KB Përparimi Tokë Bujqësore Miroc I
Njësia nr.09: Pasuria Bujqësore Toka në Kosinë (Lot B)	Njësia nr.51: NSH Produkt Toka bujqësore në Klinën e Epërme parcelat 871-3 dhe 872-1	Njësia nr.101: KB Përparimi Tokë Bujqësore Llaushë
Njësia nr.11: NTSh Sharr Depoja në Kaçanik	Njësia nr.52: Lokali Afarist nr.2	Njësia nr.102: Marketing Export Lokali Lipjan
Njësia nr.12: Agrokultura Toka në Gjilan (Lot J)	Njësia nr.53: Ereniku PP - Toka Bujqësore në Rastavicë	Njësia nr.105: Bujqësia Tokë Bujqësore Uglar II
Njësia nr.13: Pasuria Bujqësore Toka në Rahovicë (Lot C)	Njësia nr.54: KBI Bujqësia - Parcela nr.1-44 në Qeskovë	Njësia nr.106: KB Kosova Tokë Bujqësore Livagjë I
Njësia nr.14: KB Zhegra Toka në Lladovë (Lot B)	Njësia nr.55: KBI Bujqësia - Parcelat nr. 30-1, 30-2 në Nagllavë	Njësia nr.107: KB Kosova Tokë Bujqësore Livagjë II
Njësia nr.15: Agromorava Toka në Gushicë (Lot A)	Njësia nr.56: NSH KB Kooperimi - Tokë bujqësore Vitomirica 1	Njësia nr.108: NSH Lavërtari Blegtori
Njësia nr.16: Agrokultura Toka në Gjilan (Lot M)	Njësia nr.58: NPB Malishgani - Parcela nr. 195-8 në Klinë	Njësia nr.109: NBI Rahoveci - Prona në Retijë 2
Njësia nr.17: Agrokultura Toka në Gjilan (Lot G)	Njësia nr.59: NPB Malishgani - Parcela nr. 158-48 në Zllakuqan	Njësia nr.110: NBI Rahoveci - Prona në Retijë 3
Njësia nr.19: R. Agushi Toka Bujqësore në Elezaj	Njësia nr.60: NPB Malishgani - Parcela nr. 83-1 në Dranashiq	Njësia nr.111: Shitorja në fshatin Kërstec
Njësia nr.20: Pasuria Bujqësore Toka në Tankosic (Lot A)	Njësia nr.61: NSH Ereniku PP - Toka Bujqësore në Raqë 1	Njësia nr.113: NSH Lavërtari-Blegtori
Njësia nr.21: Agromorava Toka në Slatinë të Epërme (Lot A)	Njësia nr.62: NSH Ereniku PP - Toka Bujqësore në Raqë 2	Njësia nr.114: NBI Rahoveci - Prona në Hoqë të Madhe 6
Njësia nr.22: Agrokultura Toka në Gjilan (Lot B)	Njësia nr.63: KB Dubrava - Toka bujqësore në Gurrakoc	Njësia nr.115: NBI Rahoveci - Prona në Hoqë të Madhe 7
Njësia nr.23: Agrokultura Toka bujqësore Lushtë 1	Njësia nr.64: KB Dubrava - Toka bujqësore në Orrobërdë	Njësia nr.116: NBI Rahoveci - Prona në Hoqë të Madhe 8
Njësia nr.24: Agrokultura Toka bujqësore Lushtë 2	Njësia nr.65: NPB Malishgani Toka Bujqësore në Klinavc	Njësia nr.117: DTP Mlladosot - Objekti nr 2 në Sevce
Njësia nr.25: Produkti Parcelat 00851-0 dhe 00852-0 në Klinën e Epërme	Njësia nr.66: NPB Malishgani Toka Bujqësore - Zllakuqan 1	Njësia nr.118: NBI Suhareka - Parcela në Sallagrazhdë 3
Njësia nr.26: Produkti parcelat 755-0 dhe 797-0 në Kopiliq i Poshtëm	Njësia nr.67: NPB Malishgani Toka Bujqësore Qeskovë	Njësia nr.119: NBI Rahoveci - Prona në Brestoc 4
Njësia nr.27: Produkt parcelat 955-0, 956-0 dhe 957-1 në Baks	Njësia nr.68: NPB Malishgani Toka Bujqësore Zllakuqan 2	Njësia nr.120: NSH D.L.B. Lavërtari-Blegtori- Tokë bujqësore në Korishë 1
Njësia nr.28: Elan Parcela 00083-0 në Liqej	Njësia nr.69: NPB Malishgani Toka Bujqësore Grabanicë 1	Njësia nr.121: NSH D.L.B. Lavërtari-Blegtori- Tokë bujqësore në Korishë 2
Njësia nr.29: NSH Produkti Tokë në Dashevc	Njësia nr.70: NPB Malishgani Toka Bujqësore Grabanicë 2	Njësia nr.122: NBI Rahoveci - Prona në Brestoc 2
Njësia nr.30: NSH LUX Lokali Treshnja	Njësia nr.71: NPB Malishgani Toka Bujqësore në Jashanicë	Njësia nr.123: NBI Rahoveci Prona në Dejnë 2
Njësia nr.31: NSH Produkti Tokë në Polac i Vjetër	Njësia nr.72: NSH Produkti Dyqani në Aslan Çeshme	Njësia nr.124: NBI Rahoveci - Prona në Brestoc 1
Njësia nr.32: Agrokultura Furra e Vjetër në Stantërg	Njësia nr.73: Nsh Deva ngastra nr.705 ZK Devë	Njësia nr.125: NBI Rahoveci Prona në Retijë 1
Njësia nr.33: Produkti Tokë në Bajë	Njësia nr.74: NPB Malishgani Ngastra nr. 247-1 në Dranashiq	Njësia nr.126: NSH Zadruga Shtërpce -Toka bujqësore Vërbeshtica 2
Njësia nr.34: Produkti Tokë në Suhogërrilë	Njësia nr. 76: KB Kooperimi - parcela nr. 1145-0 në Vitomiricë	Njësia nr.127: NSH D.L.B Lavërtaria-Blegtoria - Prona në Zojz 1
Njësia nr.35: Produkti Tokë në Klodërnice	Njësia nr.77: NSH Ereniku PP Parcela nr. 169/2 në ZK Zidi i Sadik Agës	Njësia nr.128: NSH D.L.B Lavërtaria-Blegtoria - Prona në Zojz 2
Njësia nr.36: Produkti Tokë në Obri e Poshtme	Njësia nr.79: Toka bujqësore në Llukac të Thatë	Njësia nr.129: NSH Vreshtaria Toka Bujqësore në Shpenadi 1
Njësia nr.37: Elan Parcela 205 ZK Beçuk	Njësia nr.80: NSH Ereniku Prodhimtaria Primare	Njësia nr.130: NBI Rahoveci - Prona në Hoqë të Vogël 7
Njësia nr.38: Elan Parcela 761 ZK Zhilivodë	Njësia nr.84: Visoko Commerce Shitorja nr. 2	Njësia nr.131: NBI Rahoveci - Prona në Hoqë të Vogël 8
Njësia nr.39: Elan Parcela 114-1 ZK Stanovc i Epërm/Përronaj	Njësia nr.86: Bujqësia Tokë Bujqësore Milloshevë V	Njësia nr.132: NT Koritniku - Shitore në fshatin Orqushë, Dragash
Njësia nr.40: Elan Parcelat 1041-0 dhe 1045-0 në Dumnicë e LLugës/Mesme	Njësia nr.87: KB Kosova Tokë Bujqësore Bregu i Zi	Njësia nr.133: NSH Podrima - Shitorja nr.4 në Rahovec

* Shënim: Njësitë në vijim janë tërhequr nga Shitja e Aseteve - 39

Njësia nr.18: Agrokultura Toka në Malishevë (Lot C)
Njësia nr.57: NPB Malishgani - Toka Bujqësore në Klinë
Njësia nr.75: KB Kooperimi - Toka bujqësore Sigë 1
Njësia nr.78: Ereniku Tregtia Shitorja në Brekoc
Njësia nr.81: NSH Ereniku PP Toka Rastavica D
Njësia nr.82: Kosovarja Shitorja nr. 2
Njësia nr.85: Jugoplastika Shitorja Mitrovicë

Njësia nr.89: Ratar Tokë Bujqësore Graçanicë II
Njësia nr.90: Ratar Tokë Bujqësore Graçanicë III
Njësia nr.91: KB Shtime Tokë Bujqësore Rashincë I
Njësia nr.99: Tokë Bujqësore Miradi e Epërme VIII
Njësia nr.103: Ratar Tokë Bujqësore Hajvali I
Njësia nr.104: Bujqësia - Tokë bujqësore Uglar 1
Njësia nr.112: NSH Liria Lokali në Prevallë

* Të gjithë ofertuesit potencial të cilët planifikojnë të dorëzojnë ofertën për asetet e përfshira në Shitjen nr. 39 të Aseteve janë të obliguar që të përdorin dhe të plotësojnë në tërësi VETËM shtojcat të formatin e përfshirë në Rregullat e Tenderit në fuqi, përndryshe oferta e tyre mund të DISKUALIFIKOHET!
Formularët mund të shkarkohen në ueb faqen e AKP-së apo të tërhiqen në zyrën e marketingut në AKP.

Për më shumë kontaktoni - Njësinë për Marketing dhe Marrëdhënie me Investitorë
Rr. Agim Ramadani Nr. 23, (ish Rr. Ilir Konushevc Nr.8), 10 000 Prishtinë, Kosovë
tel: +383 (0) 38 500 400, lok. 2004, 1090, 1105 ose 1152 / fax +383 38 248 076
e-mail: shitja@pak-ks.org ose sales@pak-ks.org; www.pak-ks.org

Lumë's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898
Sallon Depilimi Lumë's Details
lumescdetails
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ "Euro Pixel" SH.P.K. shpallë të pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb. 71132617 me seli në Prishtinë.
- ▶ Sabri Mustafa shpall të pavlefshme deftesat dhe diplomën e shkollës së mesme gjimnazi "Hamzë Jashari" Skenderaj.
- ▶ Majlinda Kuçica shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme gjimnazi "Hamzë Jashari" Skenderaj.
- ▶ Urgjentisht kërkohet një banesë me qera për një familje me dy dhoma gjumi. Banesa duhet të jetë e mobiluar bukur dhe është për afat të gjatë. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 049/472-770.
- ▶ Urgjentisht kërkohet banesë për blerje në Fushë Kosovë. Çmimi 25.000-30.000 Euro Tel 044/741-155.
- ▶ Lëshoj banesa me qira afër Eulex-it, ish Farmedi, në lagje të spitalit, banesa është e lirë që nga data 01.08.2018. Banesat janë të ndërtuar nga kompania "Cima Contrekshen" njëra banesë ka 112 metër katror ndërsa tjetra 85 metër katror. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 044-923-527 dhe 044-402-679.
- ▶ Urgjentisht kërkohet një banesë me qera për një person të huaj, Banesa duhet të jete jo shumë larg qendrës, mundësisht tek "Qafa" ose "Tophane" Duhet të ketë dy dhoma gjumi, te jete e mobiluar bukur. Çmimi deri 300 euro. Për info: Tel 049-472-770
- ▶ Lëshoj me qira banesën në Prishtinë, Lagja Mati 1, rr. Ndue Perllëshi (pas 13 katshes). Banesa ka 58 m. katrorë, e mobiluar. Nr. kontaktues 044-121-668 ose 044-172-938. Çmimi sipas marrëveshjes.
- ▶ Urgjentisht kërkohet një banesë me qira ne Fushë Kosovë, për një familje 3 anëtarësh. Banesa duhet të ketë 2 dhoma gjumi, dhomë dite, kuzhinë dhe poashtu të jetë e mobiluar. Banesa kërkohet për afat më të gjatë. Info në tel: 044-741-151
- ▶ Urgjentisht kërkohet banesë me qira për një çift ne Fushe Kosove. Banesa duhet të ketë një dhomë gjumi dhomë dite me kuzhinë te jete e mobiluar, çmimi: 150-200 euro. Tel 044-741-155
- ▶ Urgjentisht kërkohet banesë me qira ne Prishtinë, për një çift me një fëmijë. Banesa duhet të ketë 1 dhomë gjumi dhomë dite me kuzhinë. Po ashtu të jetë e mobiluar si dhe të jetë afatgjatë. Çmimi 200 euro. Tel: 044-741-155
- ▶ Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.
- ▶ Lëshoj me qira banesën tri dhomëshe në Bregun e Diellit, mbrapa konvikteve të studentëve, kati VI- lifti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxehe qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe depozitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958
- ▶ Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.
- ▶ Agjencia për patundshmëri "SAZANI", kërkon për blerje dhe lëshojmë me qira: banesa, shtëpi, lokale, troje dhe toka. Ndërmjetësojmë me korrektësi si dhe shesim disa sosh. Numri kontaktues: 044-207-474.
- ▶ Shes shtëpinë në rrugën "Haxhi Zeka" afër Shkollës Teknike në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 049-909-641.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Ulpiana" afër AAK-së në Prishtinë. Për informata më të hollësishme lajmërohuni në këtë numër të telefonit: 044-162-783

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

Prishtinë



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Industria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



AUTOSHKOLLA “RITMO – L”

**Auto Shkolla
“RITMO - L”
Prishtinë**

**Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.**

Ju mirëpret:

Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "

Tel / kontakt:

044 248 173

044 200 604

044 375 333